



# ANALIZA

**Maqedonia në epokën digjitale  
– midis të drejtave dhe përgjegjësive  
gjatë komunikimit në internet**

*Kjo Analizë u publikua në kuadër të Projektit “Maqedonia në epokën digjitale – midis të drejtave dhe përgjegjësive gjatë komunikimit në internet”*

# ANALIZA: Maqedonia në epokën digjitale – midis të drejtave dhe përgjegjësi gjatë komunikimit në internet



Botuesi: Instituti Maqedonas për Media (IMM)

Juri Gagarin 17-1/1, 1000 Shkup

Republika e Maqedonisë

Për botuesin: Biljana Petkovska, drejtore

Udhëheqës i hulumtimit: Petrit Saraçini

Ekipi hulumtues: Petrit Saraçini

Filip Medarski

Llazar Sandev

Jane Stefanov

Sllavço Milenkovski

Përkthimi dhe lektura: Sami Bushi

Disenji: Jane Stefanov

CIP - Каталогизacija во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје  
047.738.5:316.772]:340.13(497.7)

MAQEDONIA në epokën digjitale - midis të drejtave dhe përgjegjësi gjatë komunikimit në internet : analiza / [udhëheqës i hulumtimit Petrit Saraçini ; përkthyes Sami Bushi]. - Shkup : Instituti maqedonas për media, 2015. - 44 стр. ; 21 см  
Превод на делото: Македонија во дигиталната ера - меѓу правата и одговорностите при комуницирањето на интернет : анализа. - Фусноти кон текстот. - Публикацијата е во рамките на проектот: "Maqedonia në epokën digjitale - midis të drejtave dhe përgjegjësi gjatë komunikimit në internet"

ISBN 978-9989-158-19-3

а) Интернет комуникација - Правна рамка - Македонија б) Интернет медиуми  
COBISS.MK-ID 99984394



Ky projekt është pjesërisht i mbështetur me grant nga Ambasada e SHBA-ve. Mendimet, zbulimet dhe konkluzionet ose rekomandimet e paraqitura këtu janë të implementuesit/autorëve dhe nuk i reflektojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë së SHBA-ve.

# **ANALIZA: MAQEDONIA NË EPOKËN DIGJITALE – MIDIS TË DREJTAVE DHE PËRGJEGJËSIVE GJATË KOMUNIKIMIT NË INTERNET**

## **PËRMBAJTJA**

<b>ANALIZA: MAQEDONIA NË EPOKËN DIGJITALE – MIDIS TË DREJTAVE DHE PËRGJEGJËSIVE GJATË KOMUNIKIMIT NË INTERNET</b>	<b>3</b>
<b>HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>1. LËNDA DHE PËRMBAJTJA E STUDIMIT, QASJA METODOLOGJIKE</b>	<b>7</b>
<b>1.1. LËNDA DHE PËRMBAJTJA E STUDIMIT</b>	<b>7</b>
<b>1.2. METODOLOGJIA E GRUMBULLIMIT TË TË DHËNAVE</b>	<b>8</b>
<b>1.3. PËRMBLEDHJA E STUDIMIT</b>	<b>9</b>
<b>2. PASQYRA E PËRGJITHSHME E GJENDJEVE ME MEDIAT E INTERNETIT DHE KOMUNIKIMET NË MAQEDONI</b>	<b>11</b>
<b>2.1. RREGULLAT JURIDIKE DHE MEDIAT E INTERNETIT NË MAQEDONI</b>	<b>14</b>
<b>2.2. LEGJISLACIONI LIDHUR ME PUBLIKIMIN E PËRMBAJTJEVE</b>	<b>14</b>
2.2.1. KONVENTAT NDËRKOMBËTARE DHE KUSHTETUTA	14
2.2.2. KODI PENAL	15
2.2.3. PËRGJEGJËSIA PËR SHPIFJE DHE FYERJE PËR PUBLIKIM NË MEDIA TË INTERNETIT DHE RRJETE SOCIALE	18
2.2.4. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE DHE MEDIAVE TË INTERNETIT	23
2.2.5. APLIKIMI I LIGJIT MBI PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI	25
2.2.6. MEDIAT E INTERNETIT DHE LIGJI MBI TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E NGJASHME	26
2.2.7. QASJA E LIRË NË INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK	28
2.2.8. MEDIAT E INTERNETIT DHE LIGJI MBI MEDIAT	30
<b>2.3. MARRËDHËNIET AFARISTE DHE TË PUNËS</b>	<b>30</b>
2.3.1. THEMELIMI I MEDIAVE TË INTERNETIT NGA SHOQËRITË TREGTARE	30
2.3.2. MEDIAT E INTERNETIT TË THEMELUARA NGA SHOQATA TË QYTETARËVE	32
2.3.3. REGJISTRIMI I DOMENIT	33
2.3.4. LIGJI PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE MEDIAT E INTERNETIT	34
2.3.5. ZBATIMI I LIGJIT MBI MATERIALIN ARKIVOR	38
<b>2.4. VETËRREGULLIMI</b>	<b>39</b>
2.4.1. KËSHILLI I NDERIT I SHGM	39
2.4.2. KËSHILLI PËR ETIKË NË MEDIA-KEMM	40
2.4.3. FORMAT TJERA TË BASHKIMIT PROFESIONAL TË MEDIAVE TË INTERNETIT	41
<b>3. PERCEPTIMET E AUDIENCËS SË INTERNETIT PËR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT DHE VETËRREGULLIMIT NË INTERNE (ANKETA)</b>	<b>42</b>
<b>4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME</b>	<b>44</b>



# HYRJE

## RRETH STUDIMIT DHE PROJEKTIT

Media Instituti i Maqedonisë (MIM) përpiloi këtë studim në kuadër të Projektit

“Maqedonia në epokën digjitale – midis të drejtave dhe përgjegjësive gjatë komunikimit në internet”, financuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara Amerikës në Shkup. Synimi kryesor i këtij Projekti është të mbështetet një diskurs më i përgjegjshëm dhe më demokratik në komunikimin publik online në Maqedoni.

Si pjesë e aktiviteteve që po zbatohen në kuadër të Projektit, përpilimi i studimit ka për qëllim të kontribuojë për hapjen e një debati thelbësor publik mbi komunikimin institucional dhe kornizën juridike përbrenda të së cilës funksionojnë mediat online, por dhe mbi komunikimin elektronik të qytetarëve në përgjithësi.

Në këtë kuptim, është me rëndësi të posaçme identifikimi i pjesëve kryesore të legjislacionit të Republikës së Maqedonisë, të cilat krijojnë kornizën juridike për funksionimin e komunikimit masovik nëpërmjet të internetit, por dhe tendencat, sfidat dhe shkeljet që kanë të bëjnë me zbatimin

min e normave ligjore në fushën e komunikimit online dhe mediave të internetit. Studimi njëkohësisht ofron një pasqyrë të një pjese të aktiviteteve të ndërmarra nga aktorët shoqëror – institucionet, mediat ose organet/organizatat tjera për zgjidhjen e gjendjeve, efikasitetin e tyre dhe balancin e tyre në kuptimin e lirisë së shprehjes dhe të drejtave tjera fundamentale të njeriut.

Ky studim bazohet mbi një punim dhe vëzhgimi hulumtues paraprak të përmbajtjeve mediatike të bëra në këtë aspekt nga organizata dhe ekspertë të ndryshëm mediatikë dhe qytetar, duke përfshirë këtu dhe analizat, hulumtimet dhe vëzhgimin e përmbajtjeve mediatike të kryera nga MIM, Shkolla e Lartë e Gazetarisë dhe Marrëdhënieve me Publikun, shoqatave dhe organizatave mediatike, si dhe aktorëve tjerë shoqërorë dhe profesionistë që veprojnë në këtë fushë. Ai përfshin dhe gjitha të dhënat e fundit relevante në lidhje me legjislacionin dhe praktikën gjyqësore ekzistuese, si dhe në kuptimin e punës dhe aktiviteteve të institucioneve shtetërore që kanë të bëjnë me komunikimin elektronik.



# 1. LËNDA DHE PËRMBAJTJA E STUDIMIT, QASJA METODOLOGJIKE

## 1.1. LËNDA DHE PËRMBAJTJA E STUDIMIT

Analiza është përpiluar në përputhje me metodologjinë që jep drejtime rreth strukturës së analizimit të gjendjeve të zbatimit të ligjeve në fushën e komunikimit online, nëpërmjet të segmenteve në vijim:

### Pasqyra e përgjithshme e gjendjes në lidhje me respektimin e legjislacionit në fushën e mediave online dhe komunikimeve në Maqedoni

Në fillim të studimit jepet një kontekst i shkurtër lidhur me ambientin mediatik dhe rolin e mediave online dhe rrjeteve sociale në debatin publik, duke filluar nga qasja në teknologjitë e reja dhe internetin, mënyra e përdorimit të mediave dhe teknologjive të reja vis-a-vis atyre tradicionale, përhapja e shfrytëzimit të shërbimeve në internet dhe shfaqja e mediave të reja, si dhe niveli i shkrim-këndimit mediatik të popullatës dhe gazetarëve; studimi në këtë pjesë do të jep një pasqyrë të përgjithshme të gjendjeve me respektimin e legjislacionit gjatë komunikimit dhe shpalljes së përmbajtjeve në internet. Me këtë, studimi do të fokusohet në atë pjesë të legjislacionit të vendit ku në përgjithësi mundësohet funksionimi juridik i subjekteve në komunikimin e internetit dhe është i lidhur në mënyrë thelbësore – me veprimin e tyre afarist, si dhe me përmbajtjen që ata plasojnë.

Si ligje të rëndësishme që çdo ditë ndikojnë mbi përmbajtjen dhe punën dhe funksionimin afarist të mediave të internetit dhe të komunikimit, studimi i referohet Kushtetutës, KEDNJ-së (Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), Kodit Penal, Ligjit mbi Përgjegjësinë Qytetare për Shpifje dhe Fyerje, Ligjit mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit mbi Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjit mbi të Drejtat e Autorit, Ligjit mbi Qasjen e Lirë në Informacione me Karakter Publik, përderisa do t'i referohemi dhe Ligjit mbi Mediat dhe Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale dhe përjashtimit që bën për mediat e internetit, si dhe Ligjit mbi

Marrëdhëniet e Punës dhe ligjeve lidhur me pagimin e honorarëve, Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare, Ligjit mbi Shoqatat Qytetare dhe Fondacionet, regjistrimit të domeneve në MARnet, si dhe Ligjit mbi Arkivimin. Me studimin përfshihen pjesë të rëndësishme të këtyre ligjeve që kanë të bëjnë me funksionimin elementar të mediave të internetit në jetën e përditshme.

### Korniza juridike dhe përfshirja e normave ligjore që prekin fushën e mediave online

Synim i këtij studimi është të hulumtohen, sistematizohen dhe sublimohen normat më të rëndësishme ligjore ose pjesët e tyre që krijojnë kornizën juridike në fushën e mediave online dhe komunikimit online. Si më të rëndësishme dhe më relevante dhe lëndë e interesit të këtij studimi, ndajmë aktet e përgjithshme juridike në vijim:

- Aktet juridike lidhur me përmbajtjen – ato që garantojnë lirinë e shprehjes dhe ngërthejnë në vete kufizimet e publikimit të përmbajtjeve që mund t'i cenojnë të drejtat e të tjerëve
- Ligjet lidhur me funksionimin afaristo-juridik të subjekteve në komunikimin në internet, duke filluar nga mundësia e themelimit të një subjekti, e deri tek rregullimi i marrëdhënieve të punës dhe funksionimi i tregut të informacioneve
- Mekanizmat dhe procedurat ligjore, praktika gjyqësore, ndëshkimi dhe përgjegjësia

Studimi i bën të ditura mënyrat se si funksionojnë legjislacioni dhe mekanizmat që mund të shfrytëzohen për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe subjekteve që marrin pjesë në komunikimet online. Nëpërmjet të dëftimit të rasteve konkrete, por duke respektuar prezumimin e pafajësisë dhe privatisë, pa komentuar aktgjykimet ose rastet që janë në procedurë e sipër, studimi do t'i referohet praktikës gjyqësore të organeve tjera shtetërore lidhur me zbatimin e këtyre ligjeve, duke shënuar nëpërmjet të shembujve konkret procedurat juridike dhe administrative që janë aplikuar në ato raste.

Për analizën nuk është më relevantja se në dobinë e kujt ka sjellë vendimin gjykata ose organi shtetëror, si për opinionin publik ashtu dhe për



vepruesit e interesuar, mjafton të dinë se nëse ka filluar një procedurë gjyqësore ose tjetër në bazë të një ligji të caktuar, në të cilën është përfshirë një ueb faqe ose publikim në rrjetet sociale, se ky ligj vlen dhe për fushën online dhe përfshin mediat dhe qytetarët që përdorin internetin si një platformë të plasimit të informacioneve deri tek publiku i përgjithshëm.

Është po ashtu shumë e rëndësishme që gjithë vepruesit që prodhojnë dhe plasojnë përmbajtje në internet që të dinë se çka mund të presin nëse shkelin dispozitat ligjore të legjislacionit që është relevant dhe për internetin. Si pjesë e analizës përfshihen dhe pasojat juridike dhe ndëshkimet lidhur me mosrespektimin e normave relevante ligjore.

### **Përvojat dhe perceptimet e palëve të interesuara dhe publikut**

Përveç pasqyrës së legjislacionit dhe mënyrave të funksionimit të tij me shembuj konkret, studimi u referohet dhe studimeve, njohurive, perceptimeve dhe përvojave të vepruesve të interesuar (pronarë, redaktorë dhe gazetarë në media online, shoqata profesioniste dhe pjesë të publikut të internetit, të kompletuar nëpërmjet të intervistave kualitative të semistrukturuara dhe nëpërmjet të anketës online).

### **Vetërregullimi dhe standardet profesioniste**

Studimi dokumenton dhe një pjesë të praktikës së organeve tona vetërregulluese etike në rastet kur lëndë e shqyrtimit të tyre kanë qenë mediat online, por dhe forma tjera të vetërregullimit (nëpërmjet të aktiviteteve të lëvizjeve dhe organizatave ekzistuese qytetare, të grupeve joformale, të forumeve, të rrjeteve sociale), si dhe praktikat dhe standardet e mira që duhet të respektohen nga gjithë mediat, pavarësisht nga platforma e transmetimit të informacioneve që përdorin atë.

### **Rekomandimet**

Objekti i studimit, po ashtu, është identifikimi i “ngushticave”, sidomos në kuptimin e zbatimit të legjislacionit që garanton të drejtat e njeriut dhe liritë mediatike në mënyrë të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikimin në internet.

Analiza ngërthen në vete dhe rekomandime mbi mënyrat e përmirësimit të gjendjeve në fusha të caktuara ku do të përcaktohen shkelje dhe ngecje.

## **1.2. METODOLOGJIA E GRUMBULLIMIT TË DHËNAVE**

Gjate përpilimit të studimit janë përdorur qasjet metodologjike në vijim:

### **Grumbullimi i të dhënave statistikore dhe i të dhënave tjera sekondare**

Gjatë përpilimit të studimit janë marrë parasysh aktet kryesore juridike që rregullojnë marrëdhëniet në këtë fushë, duke përfshirë këtu dhe Kushtetutën, ligje dhe akte nënligjore të shumta, praktikën gjyqësore dhe procedurat për realizimin e të drejtave të subjekteve që përdorin komunikimin me internet si mjet shprehjeje ose aktiviteti afarist, si dhe mekanizmat e vetërregullimit.

Si burime të të dhënave relevante, shembujve dhe rasteve në kontekstin e këtij studimi janë përdorur të dhëna nga institucionet shtetërore, përfshirë këtu dhe të dhënat publikisht të disponueshme të Entit Shtetëror për Statistikë, Gazetës Zyrtare, Regjistrin Qendror, të buletineve gjyqësore, të akteve rregulluese ndërkombëtare (konventa, rezoluta, etj.), të praktikës gjyqësore të Gjykatës e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, të akteve dhe praktikës së Komisionit për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik, të akteve dhe praktikës së Komisionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të akteve dhe praktikës së Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe të ueb faqeve të institucioneve tjera, organizatave mediatike profesioniste, organizatave qytetare dhe mediave.

### **Intervista me veprues të interesuar dhe me grupe qëllimore**

Me qëllim të arritjes së njohurive me thelbësore mbi gjendjet, nevojave dhe sfidave me të cilat po përballen mediat online dhe komunikimi publik në internet në ambientin aktual juridik dhe shoqëror, u zbatua një hulumtim terreni dhe biseda me 20 përfaqësues të spikatur të grupeve qëllimore kryesore, duke përfshirë: pronarë të mediave online; redaktorë të mediave online; gazetarë; përfaqësues të organizatave mediatike profesion-

iste (duke përfshirë dhe organet vetërregulluese); avokatë që përfaqësojnë media online në procese gjyqësore; përfaqësues të institucioneve shtetërore (*shihni Aneksin 1, pyetësori për intervistë dhe anketë*).

### **Perceptimet e opinionit publikut për kornizën juridike dhe funksionalitetin e saj në domenin online (anketa online për opinionin publik)**

Në lidhje me informimin dhe perceptimet e publikut (opinionit publik) mbi kornizën juridike dhe mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave në domenin e internetit, në kuadër të studimit u zbatua një anketë online me komunikim të drejtpërdrejtë elektronik dhe publikim në rrjetet sociale, të cilës iu përgjigjen 135 të anketuar dhe e cila përqendrohet në përvojat dhe perceptimet e të të anketuarve në lidhje me fushat e lartpërmendura që janë lëndë e analizës (korniza juridike, mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave, gjyqësori dhe praktika, dispozitat ndëshkuese, vetërregullimi). Gjetjet e kësaj ankete po ashtu janë lëndë e analizës së këtij studimi (*Aneksi 2, anketa*).

### **1.3. PËRMBLEDHJA E STUDIMIT**

Pas miratimit të ligjeve të reja mbi mediat që nuk kanë të bëjnë me internetin, ekziston një mani e përgjithshme publike, fatkeqësisht, shpesh e përhapur nga një pjesë të mediave, institucioneve dhe vepruesve publik, se mediat e internetit dhe komunikimi elektronik “janë përjashtuar nga të gjitha ligjet dhe përgjegjësia”, gjë kjo e cila, thjeshtë, nuk është e vërtetë. Përkundrazi, shumë ligje të përgjithshme në vend kanë të bëjnë me komunikimin nëpërmjet të internetit në shumë aspekte – të drejtat e njeriut, liria e shprehjes, krimi, sjellja komerciale – blerja dhe shitja e mallrave dhe shërbimeve, të drejtat e autorit, privatësia, etj.

Ekziston një Ligj i ri mbi Shpifjen dhe Fyerjen, i cili në gjykata tregon se për shpifje dhe fyerje në internet dhe në rrjetet sociale jepet llogari; Kodi Penal përmban dispozita për vepra penale nga urrejtja nëpërmjet të sistemit kompjuterik, dhe para ca kohe, edhe për mbikëqyrje të komunikimit digjital në raste të krimit të organizuar; vendi gjithashtu ka dhe Ligjin mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili po ashtu tregon funksionalitetin në praktikë; shteti para më se një dekadë ratifikoi

Konventën mbi Krimin Kompjuterik<sup>1</sup> dhe tregon rezultate në luftimin me të; në Maqedoni ekzistojnë ligje mbi marrëdhëniet e punës, mbi marrëdhëniet e detyrueshme, e drejta kontraktuese, e drejta procesore, etj., të cilat, njëjtë si në domenet tjera ekonomike dhe shoqërore, rregullojnë marrëdhëniet midis subjekteve në tregun e informacioneve. Dhe të gjitha këto pjesë të kornizës juridike, të cilat janë të vlefshme përgjithësisht për të gjithë qytetarët, vlejnë dhe në domenin online.

Interneti në Maqedoni dhe format e komunikimit online po zhvillohen me një tempo mjaft të përshpejtuar, dhe në bazë ditore po ndryshohen dhe mënyrat në të cilat përmbajtjet arrijnë te publiku. Faktorët kryesor për këtë progres të stërmadh qasshmëria e lehtë dhe teknologjia e lirë, por dhe infrastruktura e mirë e komunikimit me internet. Shfrytëzimi i rrjeteve sociale është i stërmadh – ekzistojnë mbi 1.000.000 profile në Facebook (1.004.680 persona sipas FB), por me siguri, nëse lihen anash profilet e rrejtshme, të dyfishta dhe komerciale, ekzistojnë diku gjysmë milioni të shfrytëzuesve individual. 69,4% të amvisërive kanë pasur qasje në internet nga shtëpia. Qasje të gjerë në internet (nëpërmjet të lidhjes fikse ose celulare) kanë pasur 93,5% të subjekteve afariste me dhjetë apo më shumë të punësuar. Gjyma e subjekteve afariste kanë përdorur media sociale dhe kanë pasur ueb faqe. Gjatë vitit 2014, 7,7% të subjekteve afariste me 10 ose më tepër të punësuar kanë pasur e-tregti, gjegjësisht, kanë blerë dhe shitur mallra dhe shërbime nëpërmjet të rrjeteve kompjuterike<sup>2</sup>.

Sipas të të dhënave në MARnet, i cili paraqet një institucion të autorizuar për regjistrimin e domeneve në vend, në Maqedoni janë regjistruar 23.937 domene (domenet 7.965 .com.mk; 13.615 .mk; 614 .mkd, 821 .org.mk; 167 .net.mk; 15 .inf.mk; 340 .gov.mk; 259 .edu.mk).<sup>3</sup>

Si funksionojnë në këtë kontekst subjektet tona të internetit, sidomos mediat e internetit? Përveç publikimeve në internet të mediave tradicionale (TV dhe radio stacionet kombëtare, rajonale dhe

1 <http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=5616>

2 Shfrytëzimi i teknologjive informatike-komunikuese në subjektet afariste, Enti Shtetëror për Statistikë, 20 tetor viti 2015, <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?rbrtxt=76>

3 MARnet, statistika e domeneve <http://marnet.mk/domeni/operacii-so-domeni/statistika/>

lokale, gazetata dhe revistat), të cilat ende po i përshtaten epokës digjitale, në të cilën ato më nuk janë rojet ekskluzive të informacionit, ekziston një skenë në rritje dhe dinamike të mediave që janë të pranishme vetëm në internet.

Nga ana tjetër, zhvillimi i teknologjisë dhe potencialit të marketingut nuk u reflektua si duhet dhe në zgjerimin e strukturave redaktuese. Shumica e mediave që ekzistojnë vetëm në internet (mediat ueb-indigjene, ose mediat ueb-vendase) dhe të cilat prodhojnë përmbajtje serioze informative, kanë redaksi të vogla, punësojnë ekupe të vogla, me disa njerëz dhe japin rroga modeste, kryesisht 100-200 në muaj. Redaksitë të ekipuara me kuadro të mjaftueshme janë rrallësi e vërtetë. Si pasojë, përmbajtja shpesh gjendet në një nivel shumë të ulët profesionist. Një numër i madh i ueb faqeve ende nuk kanë rregulla për shfrytëzuesit ose politika për privatësi. Shpesh mungojnë informacione për pronar(ë) të faqeve, për redaktor, ose për atë se kush ka shkruar tekstin.

Mediat e internetit po shndërrohen të jenë një burim integruar i informacioneve, në vendin e dytë sipas konsumimit dhe ndikimit (menjëherë pas TV), por për shumicën e gazetarëve, ekspertëve, publikut të arsimuar dhe më të rritur, një pjesë e madhe të tyre janë jo të besueshme dhe i ofrojnë publikut një numër të madh të informacioneve që janë larg etikës dhe diskursit të duhur publik, dhe janë më afër propagandës dhe gjuhës së urrejtjes. Cenimet më së shumti dominojnë në rrjetet sociale, por gjithashtu, shpesh janë të pranishme në përmbajtjet e gjeneruara nga shfrytëzuesit/publiku, dhe deri në një shkallë të caktuar, dhe në përmbajtjet e prodhuara nga një numër të madh jo aq të zëshëm të mediave dhe gazetarëve.

Në lidhje me zbatimin e legjislacionit, vërehen pjesë që funksionojnë mire, një pjesë të legjislacionit po funksionon, por kanë mungesa, dhe tek një pjesë të legjislacionit vërehen probleme serioze me moszbatimin, të cilat prodhojnë kulturë të ndëshkimit dhe cenimeve serioze, si dhe dekurajim të qytetarëve dhe subjekteve të shfrytëzimit të mekanizmave ligjore, gjë kjo me të cilën ligjet po shndërrohen të jenë “shkronja e vdekur në letër”. Një përshtypje tjetër e përgjithshme është se tek ne ekziston tendenca e rregullimit të tepruar (over-regulation), ose vënia e shumë gjërave në ligjet,

të cilët pastaj bëhen tepër të gjerë, të detajuar dhe pothuajse të pazbatueshëm.

Studimi shënon se ligjet që kanë të bëjnë me themelimin e një subjekti, regjistrimin e sferës dhe një pjesë të madhe të ligjeve që kanë të bëjnë me veprimtarin afariste dhe financiare të subjekteve në internet po funksionojnë mirë dhe aty në fakt ekzistojnë më pak vërejtje nga palët e interesuara. Kjo para së gjithash ka të bëjë me Ligjin mbi Themelimin e Shoqërive Tregtare dhe me Ligjin mbi Shoqatat e Qytetarëve dhe Fondacionet, si dhe me mundësinë e regjistrimit të domenit. Nga ana tjetër, mungesa serioze po detektohen në zbatimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës, me të cilat punonjësit mediatik në internet (përveç atyre në sektorin IT) konsiderohen të jenë nga kategoritë më të rrezikuara të punonjësve të prekariatit.

Për një pjesë të legjislacionit ekzistojnë përvoja ambivalente – shihet se Ligji në një pjesë të caktuar të rasteve po funksionon mirë, se mekanizmat e zbatimit të tij janë vendosur, por kohë pas kohe shfaqen anomali. I tillë është rasti me mbrojtjen e të dhënave personale, e cila funksionon mirë, por ndodh që ajo të ngecë. Vërejtjet kryesore të palëve të interesuara vinë në lidhje me moszbatimin, mosndëshkimin ose zbatimin selektiv të Kodit Penal, Ligjit mbi Shpifjen dhe Fyerjen, asçfarë praktike në zbatimin në internet të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, shkeljet e përditshme dhe të dukshme të Ligjit për të Drejtat e Autorit. Edhe pse edhe për këto ekzistojnë shembuj të zbatimit të legjislacionit, prapëseprapë, janë shumë më tepër në numër shembujt kur për shkeljet e rregullave nuk ka përgjigje institucionale.

## 2. PASQYRA E PËRGJITHSHME E GJENDJEVE ME MEDIAT E INTERNETIT DHE KOMUNIKIMET NË MAQEDONI

Interneti dhe ambienti mediatik online në Maqedoni po zhvillohen me një tempo të përshpejtuar. Çdo ditë jemi dëshmitarë të ueb faqeve të reja dhe shërbimeve të reja që ofrohen online, por dhe të mënyrave të reja të cilat arrijnë shfrytëzuesit, gjegjësisht, publikut. Tregu i përmbajtjeve dhe shërbimeve u bë dhe aq më i lëvizshëm gjatë 4-5 viteve të kaluara.

Faktorët kryesor për këtë është qasshmëria e lehtë dhe teknologjia e lirë, si dhe infrastruktura e mirë për komunikimin me internet. Sipas të të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë lidhur me shfrytëzimin e teknologjive informatike-komunikuese në amvisëritë dhe tek individët, të publikuara më 30 tetor të vitit 2015, 69,4% të amvisërive kanë pasur qasje në internet nga shtëpia, ndërsa pjesëmarrja e amvisërive me internet të gjerë në numrin e përgjithshëm të amvisërive kishte arritur 69,0% në vitin 2015. Pothuajse gjithë (99,5%) amvisëritë me qasje në internet kanë patur lidhje të gjerë (fikse ose celulare) në internet.

Nga popullsia e përgjithshme të moshës nga 15 deri 74-vjeçare, kompjuter kanë përdorur 69,2%, ndërsa internetin kanë përdorur 70,4%. Më së shumti internetin kanë përdorur nxënësit dhe studentët, gjegjësisht 94,7%. 71,2% të shfrytëzuesve të internetit, gjatë tremujorit të parë të vitit 2015 kanë përdorur telefon celular dhe telefon të mençur për qasje në internet jashtë shtëpisë dhe jashtë punës. Sipas të të dhënave të Entit, 15,4% të personave që ndonjëherë kanë përdorur internetin, kanë porositur/blerë mallra ose shërbime nëpërmjet të internetit në 12 muajt e fundit.

Nga personat që nuk kanë blerë me internet gjatë 12 muajve të fundit, 28% nuk kanë blerë për shkak të brengosjes për sigurinë gjatë pagimit, ose të privatisisë (p.sh., dhënia e të dhënave nga kartela kreditore ose të dhënat personale në internet<sup>4</sup>).

Shfrytëzimi i rrjeteve sociale po ashtu shpërtheu – ekzistojnë mbi 1.000.000 profile në

4 Përdorimi i teknologjive informatiko-komunikuese në amvisëritë dhe tek individët, Enti Shtetëror për Statistikë, 30 tetor, viti 2015 <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?rbtxt=77>

Facebook (1.004.680 persona sipas FB), por me siguri janë jo më shumë se diku rreth gjysmë milioni të shfrytëzuesve individualë<sup>5</sup>.

Në lidhje me shfrytëzimin e teknologjive informatike-komunikuese në subjektet afariste, Enti për Statistikë në tetor të vitit 2015 shpalli se qasja e gjerë në internet (me lidhje fikse ose celulare) kanë pasur 93,5% të subjekteve afariste me dhjetë ose më tepër të punësuar. Qasje në internet nëpërmjet të aparatit transmetues, duke shfrytëzuar rrjet të telefonit celular (3G/4G) kanë patur 59,1% të subjekteve afariste. Gjysma (49,8%) e subjekteve afariste kanë shfrytëzuar media sociale (p.sh., Facebook, LinkedIn, Twitter, Presently, YouTube, Flickr, Picasa, Wiki-tools, etj.), gjegjësisht, kanë pasur një profil të shfrytëzuesit, llogari ose licenca shfrytëzimi për ndonjë media të caktuar sociale. Rreth 52% të subjekteve afariste kanë pasur ueb-faqe ose faqe fillestare, nga ato, 79% në ueb faqen kanë siguruar përshkrimin e produkteve/shërbimeve, lista të çmimeve, 40,2% kanë shënuar linqe/referenca që çojnë drejt profileve të tyre në mediat sociale, përderisa 16,4% kanë siguruar porosi dhe rezervime online. Gjatë vitit 2014, 7,7% të subjekteve afariste me 10 ose më shumë të punësuar kanë pasur e-tregti, gjegjësisht kanë blerë dhe shitur mallra ose shërbime nëpërmjet të rrjeteve kompjuterike<sup>6</sup>.

Sipas të dhënave në MARnet, i cili është një institucion i autorizuar për regjistrimin e domeneve në vend, në Maqedoni janë regjistruar 23.937 domeni (domenet 7.965 .com.mk; 13.615 .mk; 614 .mkd, 821 .org.mk; 167 .net.mk; 15 .inf.mk; 340 .gov.mk; 259 .edu.mk)<sup>7</sup>

Përveç publikimeve në internet të mediave tradicionale, ekziston një skenë në rritje dhe dinamike të mediave që janë të lindura dhe të pranishme vetëm në internet (web-native media). Duke vështruar statistikën e agreguesve të ndryshëm të lajmeve, më se 200-300 nga to janë në

5 Group of authors, "Hate speech in online media in South East Europe", Albanian Media Institute 2014, pg 101, <http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/Hate%20speech%20in%20online%20media%20in%20SEE.pdf>

6 Përdorimi i teknologjive informatiko-komunikuese në subjektet afariste, Enti Shtetëror për Statistikë, 20 tetor, viti 2015, <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?rbtxt=76>

7 MARnet, statistika e domeneve <http://marnet.mk/domeni/operacii-so-domeni/statistika/>

gjendje të arrijnë publik ditor nga mbi 10.000 lexues, por shumica e tyre merren me argëtim, dhe mbase vetëm një e dhjeta e tyre merren në mënyrë më serioze dhe më të strukturuar me prodhim të mëvetësishëm të përmbajtjeve lidhur me problemet politike, ekonomike, arsimore dhe problemet tjera me interes publik, gjë kjo e cila nuk është përjashtim nga trendi botëror i “tabloidizimit” të mediave.

Mediat e internetit gjithnjë e më tepër po bëhen burim mejnstrim i informacioneve, por për shumicën e gazetarëve, ekspertëve, publikut të arsimuar dhe më të rritur, ato janë jo të besueshme dhe i ofrojnë publikut një numër të madh të informacioneve që janë larg etikës dhe diskursit të duhur publik, dhe janë më afër propagandës dhe gjuhës së urrejtjes. Ndarjet politike, etnike dhe fetare po replikohen dhe në sferën online – më së shumti duke dominuar në rrjetet sociale, por gjithashtu, shpesh janë të pranishme në përmbajtjet e gjeneruara nga shfrytëzuesit/audienca, (User Generated Content - UGC), dhe deri në një shkallë të caktuar, gjithashtu, në përmbajtjet e prodhuara nga gazetarët.

Shumica e mediave që ekzistojnë vetëm në internet (mediat ueb-indigjene, ose mediat ueb-vendase) dhe të cilat prodhojnë përmbajtje serioze informative, kanë redaksi të vogla, punësojnë ekupe të vogla, me disa njerëz dhe japin rroga modeste, kryesisht 100-200 në muaj. Redaksitë të ekipuara me kuadro adekuate dhe të mjaftueshme janë të shumë të rralla. Si pasojë, përmbajtja shpesh gjendet në një nivel shumë të ulët profesionist. Një numër i madh i ueb faqeve ende nuk kanë rregulla për shfrytëzuesit ose politika për privatësi. Shpesh mungojnë informacione për pronar(ë) të faqeve, për redaktor, ose për atë se kush ka shkruar tekstin.

Njëra nga dukuritë më mbresëlënëse është përsëritja e pothuajse përmbajtjes identike (përmbajtja e lajmeve ose mendimeve të personaliteteve të shquara publike) në disa media online në të njëjtën kohë, gjë kjo e cila tregon se nganjëherë ekziston bashkëpunimi joformal (politik dhe/ose pjesërisht i motivuar) midis grupeve të ueb faqeve, dhe se përmbajtja të cilën këto “grupe” të ueb faqeve shpallin, është kontrolluar nga qendra të caktuara të fuqisë politike dhe ekonomike.

Veç kësaj, mediat kanë shumë lajme përsëritëse të agjencive të lajmeve ose përmbajtjeve tjera që nuk janë krijuar nga redaksia (siç janë komunikata, reagime, etj. Nga krijues jomediatik të të përmbajtjes) dhe përmbajtje shumë triviale, e cila në të shumtën e rasteve është përkthyer në mënyrë jashtëligjore ose është “përmbledhur” nga dikush tjetër (zakonisht media të huaja por dhe të brendshme), gjë kjo e cila është vetëm shfrytëzim i faktit se Ligji mbi të Drejtat e Autorit është dobët i zbatuar. Gazetaria hulumtuese ose qytetare, të cilat mund të zhvillohen në kuadër të mediave të internetit, janë pothuajse jo të pranishme, dhe ato kohëve të fundit po financohen kryesisht me projekte dhe konkurse të organizatave qytetare.

Mediat e internetit shfrytëzojnë përfitimet unike të internetit, siç janë interaksioni me publikun dhe përmbajtjet multimediale, të cilat përdoren në nivel elementar, e jo kreativ të shfrytëzimit. Shembujt e qasjes hiperlokale tek publikimet e internetit janë të rrallë dhe me frymë të shkurtër. Shpesh nuk ekzistojnë lidhje RSS me përmbajtjen (RSS feeds), hiperlidhje (hiper-linqe), ndërsa etiketimet (tags) dhe referencimi i ndonjë përmbajtjeje tjetër me fjalë kyçe shfrytëzohen rrallë dhe jo si duhet.

Edhe pse në vitet e kaluara shumica e ueb faqeve popullore janë të pranishme dhe në mediat virale dhe kanë profilet dhe faqet e tyre në rrjetet sociale, është e dukshme mungesa e strategjisë së përdorimit të tyre, me të cilën prezantimi në rrjetet sociale kryesisht reduktohet në kopjimin e linqeve nga ueb faqja në profil. Redaksitë ende kryesisht janë të ndara sipas platformave dhe nuk janë të integruara.

Shërbimet e ofruara nga mediat ueb ende po përpiqen të dalin nga fazat rudimentare të marketingut shoqëruës. Reklamimi në internet prapëseprapë po zhvillohet, edhe pse në krahasim me potencialin dhe publikun, duket sikur paratë në mediat e internetit dhe reklamimi po hyjnë në mënyrë të pastrukturuar dhe të ngadaltë, që është pasojë e gjendjes së vështirë ekonomike, tregut të instrumentalizuar dhe të shtrembëruar, por edhe të mangësive dhe moszhvillimit të strukturave të marketingut dhe departamenteve të marketingut përbrenda vetë internet mediave.

## Alfabetizimi mediatik në mesin e popullatës dhe gazetarëve

Në lidhje me shkrim-këndimin mediatik të popullatës së përgjithshme, IMM është njëra nga organizatat e rralla që punojnë në këtë lëmë. Në vitin 2009, Instituti inicioi dhe zbatoi një projekt tre-vjeçar për aplikimin e alfabetizimit mediatik në arsim. Në kuadër të këtij Projekti, i cili u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Byronë për Zhvillimin e Arsimit, u mbajtën rreth 60 trajnime për 1.200 profesorë dhe arsimtarë nga gjithë shkollat fillore dhe të mesme në Maqedoni, ekspertët e MIM dhe Shkollës së Lartë e Gazetarisë dhe Marrëdhënieve me Publikun përpiluan Doracak mbi Shkrim-Këndimin Mediatik për Arsimtarë, ueb faqe dhe materiale të shumta elektronike të përkushtuara në këtë temë, dhe u mbajtën dhe dy konferenca, të cilat mbledhën palët e interesuara – mediat, arsimtarët, institucionet arsimore dhe ekspertët e shkrim-këndimit mediatik.

MIM po vazhdon të punojë në këtë lëmë, duke zhvilluar trajnime për stafin shkollor dhe nxënësit mbi prodhimtarisë praktike të përmbajtjes dhe inkorporimit të elementeve të shkrim-këndimit mediatik në kontekstin e integritimit ndëretnik në procesin arsimor, në kuadër të PMIO – projektit pesë-vjeçar të USAID për integrim ndëretnik në arsim, i cili filloi në vitin 2011, qëllimi i të cilit është të përmirësohet dhe të promovohet integrimi ndëretnik në sistemin arsimor në vend.

Gjithashtu, ekzistojnë dhe disa organizata tjera që në mënyrë të tërthortë punojnë me shkrim-këndimin mediatik dhe digjital – me fokus më të ngushtë ose me audienca specifike qëllimore. Për shembull, Forumi Arsimor Rinor po organizon trajnime dhe aktivitete të ndryshme edukative për të zhvilluar të menduarit kritik tek të rinjtë, shkathtësitë e debatit dhe aftësitë multimediale, dhe ka një interes specifik të ngritjes së vetëdijes, sidomos të gjuhës së urrejtjes në internet. Fondacioni Metamorphosis për shumë vite me radhë vepron në lëmin e shkrim-këndimit digjital dhe të internetit, si dhe në atë të mbrojtjes së privatësisë.

Pas angazhimit fillestar të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës para disa viteve, para ca kohe shkrim-këndimi mediatik gjendet në Agjendën e Agjencisë së Mediave dhe Shërbimeve Media-

tike Audiovizuale, e cila mbajti disa trajnime dhe mbledhje që i janë përkushtuar kësaj teme dhe hapi një debat publik për miratimin e një Programi Kombëtar mbi Shkrim-Këndimin Mediatik, i cili, si pjesë të aktiviteteve të veta parasheh dhe ngritjen e vetëdijes dhe informimit të qytetarëve për këtë temë nëpërmjet të veglave online<sup>8</sup>. Megjithatë, është evidente se shkrim-këndimi mediatik është një temë e neglizhuar nga institucionet, publiku dhe krijuesve të mendimit publik dhe se angazhimet në këtë drejtim janë të kohëpaskohshme dhe të pamjaftueshme.

Degradimi i vazhdueshëm i cilësisë së diskursit publik, me të cilin shumë personalitete shumë të spikatura publike (madje dhe përfaqësues të institucioneve) përdorin gjuhë të papërshtatshme në publik pa asnjë pasojë për këtë, degradimi i sistemit arsimor, si dhe faktorë tjerë shoqëror prodhojnë publicitet, për shkak të të cilit nuk ekziston mundësia e debatit të denjë për pothuajse asnjë çështje me interes publik. Pjesa më e madhe e audiencës po bie pre e këtij diskursi propagandues dhe nuk është në mundësi t'u kundërvihet formave subtile të manipulimit dhe të jetë e aftë që në mënyrë kritike t'i vështrojë përmbajtjet mediatike. Kjo gjë rezulton me përforcimin e stereotipave dhe shpërthimit të gjuhës së urrejtjes, që është posaçërisht e dukshme në rrjetet sociale ose në faqet ku përmbajtja është krijuar nga shfrytëzuesit (faqet crowd-sourcing)<sup>9</sup>.

8 [http://avmu.mk/images/Nacrt\\_-\\_programa\\_za\\_mediumska\\_pismenost.pdf](http://avmu.mk/images/Nacrt_-_programa_za_mediumska_pismenost.pdf)

9 Hate Speech In Online Media In South East Europe, AMI 2013, <http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/Hate%20speech%20in%20online%20media%20in%20SEE.pdf>

## 2.1. RREGULLAT JURIDIKE DHE MEDIAT E INTERNETIT NË MAQEDONI

Rregullat juridike në lidhje me mediat e internetit në Maqedoni janë përfshirë me shumë ligje materiale në bazë të të cilave mediat e internetit po realizojnë veprimtarinë e tyre.

Në kuadër të këtij studimi do të prezantohen rregullat juridike që janë vendimtare për funksionimin e mediave të internetit. Ekzistimi dhe funksionaliteti i legjislationit juridik do të shqyrtohen nga disa pikëpamje: nga pikëpamja e përmbajtjes dhe lirisë së shprehjes përkundër kufizimeve; por dhe në kuptimin e lirisë së themelimit të një medias së internetit, mënyrat e funksionimit dhe drejtimit të tij, të drejtat dhe obligimet që dalin nga korniza aktuale juridike, si dhe nga pikëpamja e marrëdhënieve afariste dhe të punës, dhe ambienti i tregut.

Ideja e këtij studimi nuk është t'i analizojë të gjitha ligjet në të cilat përmendet fjala "internet" ose "komunikimi elektronik", pasi ashtu do të duhet të analizojmë qindra copëza të legjislationit për të arritur po të njëjtin konkluzion – rregullat *offline*, ose në jetën reale vlejnë dhe rregullat *online*, gjegjësisht, në botën virtuale. Kjo gjë vlen dhe për plasimin e përmbajtjeve, dhe në kuptimin e marrëdhënieve afariste të subjekteve që përdorin internetin për çështje biznesi – me gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga marrëdhëniet me shfrytëzuesit dhe shtetin.

## 2.2. LEGJISLACIONI LIDHUR ME PUBLIKIMIN E PËRMBAJTJEVE

Siç konkludojnë raportet e Komisionit Evropian në lidhje me mediat gjatë disa vitet e fundit, normat ligjore dhe kufizimet e lirisë së shprehjes kryesisht nuk pengojnë debatin publik, ndërsa arsyet e shkeljeve të vërejtura të lirisë së mediave kanë natyrë kryesisht politike. Përfundime të ngjashme të institucioneve ndërkombëtare dhe organizatave profesioniste kanë të bëjnë dhe me zbatimin e legjislationit në vend.

Një vlerësim i tillë mund të bëhet dhe në kontekstin e kornizës juridike dhe komunikimit online dhe mediave të internetit. Ekzistojnë dispozita të mira ligjore, por ekziston dhe mungesa e vullnetit (kryesisht politike, por gjithashtu në

mesin e palëve të interesuara, për shembull, tek gjykatat), për zbatimin e menjëhershëm të ligjeve dhe në mënyrë joselektive.

Siç thotë një gazetare shumëvjeçare dhe aktiviste në organizata profesioniste mediatike, e cila për momentin punon për një media online, tek ne, praktika nuk ndjek nivelin ligjor. Sipas saj, nuk ekziston një ligj i përsosur, nuk ekziston një ligj i cili do të parandalojë devijimin nëse dikush ka menduar për të bërë diçka jashtëligjore. Sipas saj, dhe sipas shumicës së gazetarëve, pronarëve dhe redaktorëve të intervistuar, ne kemi stërrregullim. Dhe kudo që ekziston stërrregullimi, siç thotë kjo gazetare, i vjen era korrupsion. Sipas saj, ne kemi institucione- fasadë, dhe në foljet politike dëgjohet referime të ndryshme drejt institucioneve të tilla, të cilat, de facto, shërbejnë vetëm si argument ose arsyetim. Prapa tyre, sipas kësaj gazetareje, fshihet diçka, ose klientelizëm. Dhe - aplikim selektiv të ligjeve.

### 2.2.1. KONVENTAT NDËRKOMBËTARE DHE KUSHTETUTA

Maqedonia është nënshkruese e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Bazë, gjë kjo me të cilën ky dokument është i aplikueshëm drejtpërsëdrejti në vend. Gjegjësisht, në pajtim me Nenin 118 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën paraqesin pjesë të rendit të brendshëm juridik dhe nuk mund të ndryshohen me ligj. Kështu, në Maqedoni, Neni 10 i Konventës Evropiane, si dhe standardet tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Parlamenti i Maqedonisë, janë drejtpërsëdrejti të aplikueshme. Kjo e drejtë fundamentale dhe kufizimet e mundshme janë përcaktuar me Kushtetutën, si dhe me ligje tjera, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë rregullojnë lëmi të caktuara.

Liria e shtypit dhe shprehjes është e garantuar, ndërsa censura rreptësisht ndalohet (Neni 16), por gjithashtu, në pajtim me Kushtetutën, liritë dhe të drejtat e njeriut mund të kufizohen gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, dhe kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk mund të jetë diskriminues në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, origjinës kombëtare ose sociale, pozitës pronësore ose shoqërore (Neni 54).

## 2.2.2. KODI PENAL

Në kontekstin e Kodit Penal (K3), kjo pjesë e rëndësishme e legjislacionit të Maqedonisë përfshin pjesën e komunikimit publik në platforma publike në internet që përmban gjuhë ose nxitje të dhunës dhe urrejtjes. Mediat “mainstream” në internet më së shpeshti përmbahen nga gjuha e hapur e urrejtjes. Gjuha e urrejtjes është më rrallë e qartë, por shpeshherë shfaqet në formë të fshehur, në kombinim me informacione nga burime dhe informacione të paidentifikuara dhe që ofrohen si fakte, fyerje, shpifje, e ngjashëm. Gjuha e nënkuptuar e urrejtjes nuk është një praktikë e rregullt, edhe pse shpesh shfaqet në disa media të internetit, dhe është posaçërisht e dukshme tek mediat virale/rrjetet sociale, forumet si dhe tek përmbajtjet tjera që krijohen nga shfrytëzuesit (komentet e teksteve në ueb faqet dhe postimet në Facebook, për shembull).

Pjesa më e madhe e publikut, duke përfshirë këtu dhe një pjesë goxha të madhe të audiencës së arsimuar, nuk di domethënien e vërtetë dhe definicionin e gjuhës së urrejtjes dhe shpesh ngatërron atë me forma tjera të shkeljeve të bëra nëpërmjet të mjeteve të komunikimit publik (për shembull, më së shpeshti me shpifjen dhe fyerjen).

Kodi Penal në disa nene parasheh dënime lidhur me urrejtjen – nxitje të ndryshimit të dhunshëm të rendit kushtetues (Neni 318), gjuha e urrejtjes (Neni 319, 417), si dhe dënimi kundër një personi që me ndihmën e sistemit informativ publikisht do të mohojë, në mënyrë të vrazhdë do të minimizojë, do të miratojë ose do të arsyetojë gjenocidin, krimet kundër njerëzimit ose krimet e luftës (Neni 407-a).

Gjuha e urrejtjes në Kodin Penal është rregulluar qartë me Nenin 319, ku është paraparë që vepra penale Shkaktimi i urrejtjes, përçarjes ose jotolerancës në bazë kombëtare, racore, fetare ose ndonjë baze tjetër diskriminuese, kështu si vijon: *Ai që me detyrim, torturim, rrezikim të sigurisë, shpallje të përqeshjes së simboleve kombëtare, etnike, fetare dhe tjera, me vënie në zjarr, shkatërrimin ose në ndonjë mënyrë tjetër, dëmtimin e flamurit të Republikës së Maqedonisë, ose flamujve të shteteve tjera, me dëmtimin e sendeve të huaja, me përdhosjen e përmendoreve, varreve ose në ndonjë mënyrë*

*tjetër diskriminuese, në mënyrë të menjëhershme ose jo të menjëhershme, do të shkaktojë ose do të nxisë urrejtje, përçarje ose jotolerance në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, seksit, përkatësisë ndonjë grupi të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, origjinës sociale, fesë ose bindjes fetare, llojeve tjera të bindjes, arsimimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, pengesës mendore ose trupore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, ose në çfarëdo baze tjetër të paraparë me ligj ose me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare, do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.*

Në paragrafin 2 të Nenit të cituar parashihet se: *Ai që veprën nga paragrafi (1) të këtij Neni e kryen me përbuzjen e pozitës ose autorizimit ose nëse për shkak të këtyre veprave ishte krijuar anarkia dhe dhuna kundërt personave ose dëme pronësore me masa të mëdha, do të dënohet me burgim nga një deri në dhjetë vjet.*

Ligji po ashtu parasheh kufizime kundër “personit që nënshton një person tjetër në përqeshje nëpërmjet të sistemit të informimit, për shkak të anëtarësisë së tij ose të saj në një grup me racë, ngjyrë të lëkurës, kombësi ose origjinë etnike tjetër, ose do t’i nënshtrohet përqeshjes një grup i tërë që posedon veçori të tilla, do të dënohet me dënim në para ose burgim deri në një vjet“ (ndryshimet dhe plotësimet e KP të vitit 2009, Neni 173).

Nga citimi i dispozitave bie në sy se gjuha e urrejtjes nëpërmjet të mediave të internetit nuk është inkriminuar posaçërisht, edhe pse ekzistojnë argumente të caktuara që ai të parashihet si një formë më e rëndë, e kualifikuar e veprës bazë. Argumente të tilla janë ndjeshmëria e vetë medias për përhapjen e gjuhës së urrejtjes, përhapja e përsheptuar e gjuhës së urrejtjes nëpërmjet të internetit, mundësia e postimeve anonime, etj.

Vepra penale që përmban elemente të caktuara të gjuhës së urrejtjes është dhe Miratimi ose arsyetimi i gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës nga Neni 407 -a të Kodit Penal: Ai që nëpërmjet të sistemit informues publikisht mohon, në mënyrë të vrazhdë minimizon, miraton dhe arsyeton veprat nga Nenin 403 deri 407, do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Paragrafi 2 i Nenit 407-a i Kodit Penal lexon: Nëse



mohimi, minimizimi, miratimi ose arsyetimi është kryer me qëllim nxitja e urrejtjes, diskriminimit ose dhunës kundër ndonjë personi ose grupi të personave për arsye të përkatësisë kombëtare, etnike ose racore ose për arsye të përcaktimit fetar, kryerësi do të denohet me denim burgim nga së paku katër vjet.

**Për gjuhën e urrejtjes në internet është posaçërisht e rëndësishme të theksohet vepra penale e paragrafit 4 të Nenit 144 të Kodit Penal – Rrezikimi i sigorisë:** *Ai që në mënyrë të sistemit informatik do të kërcënohet se do të kryejë vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burgim nga pesë vjet, ose dënim më i rëndë kundër ndonjë personi për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, seksit, përkatësisë së tyre ndonjë grupi të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, origjinës sociale, fesë ose bindjes fetare, llojeve tjera të bindjes, arsimimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, pengesës mendore ose trupore, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, ose në çfarëdo baze tjetër të paraparë me ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare, do të denohet me dënim burgim nga një deri pesë vjet.*

Kodi Penal gjithashtu parasheh dënim me para për ata që shprehin ose përhapin diçka nga jeta personale ose familjare e ndonjë personi që është e dëmshme për reputacionin e tij/saj (Neni 174 e KP).

Në lidhje me politikën ndëshkimore, është me rëndësi të përmendet se me ndryshimet e KP të vitit 2009, në dispozitat për matjen e dënimit (rregullat e përgjithshme për dënimin) përcaktohet një rrethanë e re të cilën gjykata duhet ta shqyrtojë gjatë përcaktimit të dënimit, Neni 39 paragrafi 5, i cili thotë se gjatë përcaktimit të peshës së veprës dhe dënimit, gjykata posaçërisht do ta shqyrtojë, pavarësisht nëse vepra penale është kryer kundër një personi ose grupi të personave ose pronës, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nëse kjo vepër është kryer për arsye të origjinës së tij ose të tyre kombëtare dhe sociale, bindjes politike dhe fetare, statusit pronësor dhe social, racës ose ngjyrës së lëkurës. Sipas ekspertëve të shquar juridik, qëllimi i ligjvënësit është i qartë: për lajthitje, pavarësisht nën cilën rrethanë, diskriminimi i tillë duhet të pranohet si

rrethanë penguese gjatë matjes së dënimit. Është kjo një rrethanë e cila duhet të rezultojë me dënim që është më afër dënimit maksimal të përcaktuar për veprën penale, sesa më afër asaj minimale<sup>10</sup>.

## **Zbatimi i Kodit Penal në pjesën e gjuhës së urrejtjes**

Kur bëhet fjalë për bërjen e hapit të fundit, zbatimit, duket sikur dhe këtu Maqedonisë prap i mungon një zbatim të duhur, të qëndrueshëm dhe joselektiv të legjislacionit.

Edhe pse gjuha e urrejtjes sanksionohet me Kodin Penal, ajo prapëseprapë është shumë e pranishme në mediat dhe nganjëherë ka pasoja serioze, ndërsa gjykatat maqedonase ende nuk kanë shpallur asnjë person si fajtor për një vepër të tillë. Denoncimet e gjuhës së urrejtjes ndaj disa faqeve të internetit dhe autorëve deri më sot, prokuroritë dhe policia kryesisht i injorojnë ose i hedhin poshtë.

Gjithashtu, është e dukshme se organet që janë kompetente sipas detyrës zyrtare, për të vepruar në lidhje me këtë formë të veprave penale (Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria Publike) nuk kanë ndërmarrë asnjë iniciativë për parashtrimin e denoncimeve të gjuhës së urrejtjes.

Veç kësaj, një faktor i rëndësishëm që ndikon mbi mosvendosjes së shprehisë së respektimit të këtyre dispozitave ligjore është dhe ndjenja e rezignimit dhe mosbesimit ndaj sistemit nga vetë qytetarëve që kanë qenë viktimë ose dëshmitarë të gjuhës së urrejtjes. Pjesa më e madhe e aktorëve të intervistuar, edhe pse vetë kanë qenë viktimë të gjuhës së urrejtjes, nuk kanë ngritur procedura përkatëse para organeve kompetente, dhe si arsye kryesore për këtë, ata shënojnë partizimin e gjyqsorit dhe animin e tij ndaj partive në pushtet, nën mbrojtjen e të cilave janë personalitete dhe shtëpi të caktuara mediatike, të cilat promovojnë gjuhën e urrejtjes në mënyrë joshembullore për komunikimin publik.

<sup>10</sup> Akad. Vllado Kambovski, d-r Mirjana L Lazarova Trajkovska "Analiza juridike e konceptit të veprës ndëshkimore të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes"

## **Praktika gjyqësore dhe funksionimi i mekanizmeve juridik, përvojat e palëve të interesuara**

Rasti i vetëm i padisë penale për nxitje të urrejtjes kombëtare, racore ose fetare (Neni 319, KP) është rasti i ndezjes së flamurit shtetëror në një fshat në afërsi të Strugës (janar, viti 2012), që është pjesë e një vargu të ngjarjeve (Karnevali i Vevçanit dhe përqeshja e Kur'anit, ndeyja e flamurit dhe kishave maqedonase, urrejtja etnike gjatë ndeshjeve sportive, të përfaqësuesve të Maqedonisë, vrasjet në Gostivar dhe Smilkovcë), për të cilat më detajisht flitet në njërin nga studimet e Shkollës së Lartë të Gazetarisë dhe Marrëdhënieve me Publikun, të cilat qart sjellin në dijeni se sa është ndikimi i mediave të internetit dhe çfarë gjendjesh mund të shkaktohen me raportimin e papërgjegjshëm dhe joprofesional<sup>11</sup>.

### *Rasti 1: Një aktivist qytetar i rregullt – lënda e gjuhës së urrejtjes, pas denoncimit – policia qorton*

Gjatë stinës së verës së vitit 2015, një udhëheqës televiziv i njohur kishte filluar të publikonte fotografat të një gazetaresje të njohur televizive dhe të internetit në profilin e vet në Facebook. Fotografitë kishin qenë të shoqëruara me komente fyese, me thirrje për të lënë numra telefoni, që është cenim i Ligjit mbi të Dhënat Personale, shqetësim personal. Gazetarja kishte denoncuar në polici, dhe atje, i kanë thënë se do të vepronin. Sipas njohurive, udhëheqësi televiziv ishte ftuar për një bisedë informative, ku atë vetëm e kanë qortuar që të pushonte së publikuari të përmbajtjes së tillë. Ai jo vetëm që nuk ishte ndalur, por ai kishte vazhduar madje dhe me një tempo të përshpejtuar, nëpërmjet të kolumnave të tij, që ndahen në disa portale, dhe nëpërmjet të rrjeteve social, me fajësime të rrejshme, se gazetarja kishte marrë honorarë nga një lider politik, duke emërtuar atë me fjalë fyese dhe shprehje seksiste.

### *Rasti 2: Disa personalitete publike me padi penale për gjuhë të urrejtjes, denoncimi i hedhur poshtë nga prokuroria*

Në stinën e pranverës të vitit 2014, disa personalitete të shquara publike (politikanë, gazetarë,

<sup>11</sup> Raporti i parë dhe i dytë i Shkollës së lartë për gazetari dhe për marrëdhënie me publikun, nga mbikëqyrja e raportimit mediatic në kudër të Katedrës së UNESCO-s për media, dialog dhe mirëkuptim të ndërsjellë, i disponueshëm në: [http://www.unescochair-vs.edu.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=102&Itemid=37&lang=mk](http://www.unescochair-vs.edu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=102&Itemid=37&lang=mk)

aktivistë qytetarë) ishin lëndë e gjuhës së qartë të urrejtjes në një faqe interneti në pronësi të një udhëheqësi të njohur televiziv. Në një shkresë të tij, përplot me fyerje ndaj tyre, udhëheqësi televiziv ftonte popullin të përballej me të përmendurit, nëse institucionet nuk do të përballeshin me të. Të përmendurit gjatë një konference për shtyp publike parashtruan denoncim deri tek Prokurori Publik Shtetëror dhe denoncuan rastin dhe në stacion policor. Më vonë, denoncimi që i ishte dërguar Prokurorit Publik Themelor në Shkup ishte hedhur poshtë si e pabazë.

### *Rasti 3: Tekstet e një aktivisti të pretenduara si “tradhti”, thirrjet për dhunë ndaj tij nuk janë sanksionuar*

Në lidhje me tekstet e një aktivisti, që janë publikuar në një faqe interneti ndërkombëtare, në disa media të internetit dhe në profile të ndryshme në rrjetet sociale, ai dhe shkresat e tij janë pretenduar si shembull i “tradhtisë”, si shembull i dikujt që duhet “të vritet, përdhunohet”, etj., gjë kjo të cilën kishte prirë një udhëheqës i njohur televiziv, me publikimet e tij në rrjetet sociale. Sipas aktivistit, publikimet kishin qenë me diskualifikime të plota, si në kuptimin e aktivizmit të tij, ashtu dhe në kuptimin e përkatësisë grupeve të caktuara që janë shënuar si “të padëshiruara” në shoqëri. Para ca kohe, në një ueb faqe popullore kishte pasur një tekst që është pjesë e polemikës së këtij aktivisti dhe një personi tjetër publik që është aktiv në rrjetet sociale. Aktivisti kishte bërë përpjekje për të biseduar me redaktorin në lidhje me tekstin e shkruar nga personi publik, pasi ai është kolumnist në atë faqe. Atij i është thënë se bëhet fjalë për një raportim për një status tanimë të publikuar në Facebook të atij personi publik, i cili është diku 120-130 rreshta dhe plotësisht po përpiqet ta diskreditojë aktivistin, si profesionalisht ashtu dhe personalisht, pikërisht në kontekstin e angazhimit të tij shoqëror dhe përkatësisë grupeve të caktuara.

## **Raste të dhunës ndaj përfaqësuesve të internet mediave**

Gjatë vitit 2015 në Maqedoni janë regjistruar disa sulme fizike ndaj pronarëve dhe redaktorëve të internet mediave, një pjesë e të cilëve ishin brutale, me pasoja fizike për të sulmuarit.

Deri në botimin e kësaj analize, për asnjë prej këtyre rasteve nuk ka informata më konkrete, as për rezultate nga hetimet e organeve të ndjekjes, as për lëndë të formuara ndaj të dyshuarve konkretë ose për nisjen e padive dhe procedurave gjyqësore konkrete për këto raste të dhunës.

### 2.2.3 . PËRGJEGJËSIA PËR SHPIFJE DHE FYERJE PËR PUBLIKIM NË MEDIA TË INTERNETIT DHE RRJETE SOCIALE

Pas dekriminalizimit të zbatuar me sukses para disa viteve dhe mënjanimit të shpifjes dhe fyerjes nga Kodi Penal, përgjegjësia qytetare për dëme të bëra ndaj nderit dhe reputacionit të një personi fizik ose juridik me fyerje dhe shpifje rregullohet me Ligjin mbi Përgjegjësinë Qytetare për Fyerje dhe Shpifje. Gjithashtu, Ligji garanton lirinë e shprehjes dhe informimit si një nga bazat e rëndësishme të shoqërisë demokratike. Kufizimi i lirisë së shprehjes dhe informimit me ligj rregullohen duke përcaktuar kushte të rrepta për përgjegjësi qytetare për fyerje dhe shpifje, në pajtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Bazë (Neni 10) dhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Si bartës të funksionit publik, Ligji konsideron çdo person zyrtar, ushtarak, person përgjegjës në një person juridik ose person që kryen punë me interes publik, sipas domethënies së atyre shprehjeve të përcaktuara me Kodin Penal. Në Nenin 5, paragrafin 2, Ligji ka përcaktuar sferat me interes publik, si vijon: të gjitha format, institucionet dhe aktivitetet e kryerjes së pushtetit shtetëror dhe institucionet publike, vetëqeverisjen lokale, vepërimtaritë shoqërore siç janë shëndetësia, kultura, artet, arsimit, shkenca, sporti, mjetet e informimit publik, sistemi juridik dhe aplikimi i së drejtës dhe sistemi ekonomik dhe marrëdhëniet ekonomike, si dhe ambienti jetësor.

Neni 5, paragrafi 3 i Ligjit gjithashtu përcakton se për rregullat profesioniste të profesionit gazetaresk konsiderohen rregullat e grumbullimit, analizimit dhe publikimit të informacioneve, të përcaktuara nga organizata profesioniste e gazetarëve.

### Fyerja

Fyerja është përcaktuar me Nenin 6 të Ligjit mbi Përgjegjësinë Qytetare për Fyerje dhe Shpifje<sup>12</sup>.

Nuk ka elemente të përgjegjësisë qytetare për fyerje nëse një portal interneti transmeton deklaratën që është dhënë gjatë punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, gjatë punës së këshilleve të komunave dhe Qytetit të Shkupit, gjatë një procedure administrative ose gjyqësore ose para Avokatit të Popullit, mendimin e transmetuar të përfshirë me një dokument zyrtar të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, organeve të administratës, gjykatave ose organeve tjera shtetërore, kumtesa ose dokumentet tjera të organizatave ndërkombëtare ose konferencave, komunikata ose ndonjë dokument tjetër për informimin e publikut, të nxjerra nga organe kompetente shtetërore, institucione ose persona tjerë juridik, kumtesa ose ndonjë dokument tjetër zyrtar nga hetime të veprave të kryera penale ose kundërvajtjeve dhe në vetë deklaratë janë transmetuar mendime gjatë një mbledhjeje publike, në një procedurë gjyqësore ose manifestim tjetër publik të aktivitetit të organeve shtetërore, institucioneve, shoqatave ose personave juridik, ose raportohet për deklaratën që publikisht është deklaruar nga një person tjetër.

12 (1) Për fyerje përgjigjet ai që me qëllim të poshtërojë, me deklaratë, sjellje, publikim ose në mënyrë tjetër, do të shpreh për tjetrin një mendim poshtëruës, me të cilin cenon nderin dhe reputacionin e tij. (2) Përgjegjësia për fyerje ekziston dhe nëse me një veprim të tillë nënvlërësohet reputacioni i personit juridik, grupit të personave ose personit të vdekur. (3) Për fyerjen e bërë nëpërmjet të një mjeti për informim publik (gazeta, revista dhe shtyp tjetër, programe në radio dhe televizion, publikime elektronike, teletekst, dhe forma tjera të përmbajtjeve programike redaktuese të formësuara të cilat po publikohen, apo emetohen në bazë ditore ose periodikisht në formë të shkruar, me ze ose në ekran, në mënyrë të jenë të disponueshme për publikun e gjerë), mund të përgjigjet autori i deklaratës, redaktori ose personi që zëvendëson atë në mjetin e informimit publik, dhe personi juridik. Padiësi, gjatë parashtrimit të padisë është i lirë të vendos kundër cilit nga personat në këtë paragraf do të ngrit padi për përcaktimin e përgjegjësisë dhe dëmshpërblimin për fyerje. (4) Publikuesi, redaktori ose personi që zëvendëson atë në mjetin e informimit publik dhe personi juridik që boton mjetin e informimit publik, për fyerjen e kryer nga gazetari në atë mjet që është autor i deklaratës, përgjigjet sipas parimit të përgjegjësisë së supozuar. (5) Në rastet e paragrafëve (3) dhe (4) të këtij Neni, gazetari, si autor i deklaratës, nuk përgjigjet për fyerje nëse dëshmon se publikimi i deklaratës fyese i është urdhëruar nga redaktori ose personi që zëvendëson atë, ose se përmbajtja e deklaratës së tij është rëndësishëm e ndryshuar nga redaktori ose personi që zëvendëson atë. (6) Gazetari, si autor i deklaratës nuk përgjigjet nëse ajo ka marrë karakterin fyes me pajisimin e saj duke vënë tituj, nëntituj, fotografi, nxjerrje të pjesëve të deklaratës nga tërësia e saj, lajmërimet ose në ndonjë mënyrë tjetër, nga ana e redaktorit ose personit që zëvendëson atë.

Në pajtim me standardet profesioniste të gazetarëve, transmetimi i një deklarate të caktuar të një personi tjetër duhet t'i atribuohet, gjegjësisht – në titullin ose në tekstin me të cilin transmetohet lajmi i caktuar, duhet të shënohet se kush ka dhënë atë deklaratë.

Në pajtim me Ligjin mbi Përcaktimin e Përgjegjësive Qytetare për Shpifje dhe Fyerje, portali i internetit nuk do të konsiderohet si përgjegjës nëse shpifja shkon drejt një kritike serioze, në kryerjen e profesionit gazetaresk, në mbrojtjen e lirisë së shprehjes publike të mendimit ose në të drejta tjera ose gjatë mbrojtjes së interesit publik ose interesave tjerë të arsyetuar, dhe me këtë, shpallja e mendimit poshtërues për tjetrin mund të përcaktohet se:

- 1) nga mënyra e shprehjes ose rrethanat e saja del se kjo gjë nuk përmban domethënie të fyerjes;
- 2) nuk ka shkaktuar cenim të konsiderueshëm të nderit dhe reputacionit të personit dhe
- 3) nuk është nxjerrë vetëm me qëllim poshtërimi i personalitetit të tjetrit ose të nënvlerësohet nderi dhe reputacioni i tij.

Gjithashtu, Ligji parasheh se nuk është përgjegjës për fyerje ai i cili do të shpall një mendim poshtërues për një bartës të funksionit publik me interes publik, nëse dëshmon se kjo është e bazuar mbi fakte të vërteta, ose nëse dëshmon se ka pasur arsye të bazuar të besojë në vërtetësinë e fakteve të tilla, ose nëse deklarata përmban një kritikë të arsyetuar ose nxit debat me interes publik ose është dhënë në pajtim me standardet profesioniste dhe etikën e profesionit gazetaresk.

## Shpifja

Përgjegjësia për shpifje përcaktohet në pajtim me Nenin 8 të Ligjit mbi Përgjegjësi Qytetare për Fyerje dhe Shpifje<sup>13</sup>.

13 Për shpifje përgjigjet ai që për një person tjetër, me identitet të konstatuar ose evident, me qëllim që të dëmtojë nderin dhe reputacionin e tij përpara personit të tretë shpall ose nxjerr fakte që janë të dëmshme për nderin dhe reputacionin e tij, përderisa di ose ka qenë i detyruar të mund të dijë se janë jo të vërteta.

Përgjegjësia për shpifje ekziston dhe nëse pretendimi i pavërtetë përmban fakte për reputacionin e një personi juridik, grupi të personave ose personi të vdekur.

Nëse shpallja ose nxjerrja e pretendimeve të pavërteta për fakte është bërë nëpërmjet të mjetit për informim publik (gazeta, revista dhe shtyp tjetër, programe në radio dhe televizion, publikime elektronike, teletext dhe forma tjera të përmbajtjeve programike redaktuese të formësuara

Në lidhje me përgjegjësinë qytetare për shpifje, ai që është paditur në një procedurë të caktuar gjyqësore, është i obliguar ta dëshmojë vërtetësinë e fakteve të përfshira në pretendim, gjegjësisht, në tekstin që është autorial. Në rast të një lajmi të transmetuar, ose një përmbajtje tjetër, nëse ajo është atribuar, portali i internetit që është paditur është i obliguar të dëshmojë se ajo është transmetuar dhe se ai nuk është autori i saj. Në lidhje me dëshmimin, mjafton të dëshmohet se ka pasur arsye elementare të besojë në vërtetësinë e pretendimeve. Me përjashtim, nuk lejohet dëshmimi i vërtetësisë së fakteve që kanë të bëjnë me jetën private të paditësit, përveç nëse nxjerrja e fakteve të tilla është bërë në një vepër shkencore, letrare ose artistike, në një kritikë serioze, në kryerje të detyrës zyrtare, të profesionit gazetaresk, në detyrë politike ose tjetër shoqërore, në mbrojtje të lirisë së shprehjes publike, të mendimit ose në të drejta tjera ose gjatë mbrojtjes së interesit publik. Nëse shpifja konsiston në kalimin publik drejt tjetrit për kryerje të veprës penale ose se është gjykuar për një vepër të tillë, përgjegjësia është përjashtuar nëse deklarata është dhënë me interes publik dhe nëse personi që kishte dhënë atë do ta dëshmojë vërtetësinë e tij ose do të vërtetojë se ka pasur arsye të bazuar të besojë në vërtetësinë e fakteve të tilla.

Ligji në Nenin 10 parasheh dhe përjashtim nga përgjegjësia për përgjegjësi qytetare për shpifje<sup>14</sup>.

që publikohen, ose emetohen në bazë ditore ose periodikisht në formë të shkruar, me zë ose në ekran, në mënyrë që janë të disponueshme për publikun e gjerë), për shpifje mund të përgjigjet autori i deklaratës, redaktori ose personi që zëvendëson atë në mjetin e informimit publik dhe personi juridik. Paditësi gjatë ngritjes së padisë është i lirë të vendos kundër cilit person nga ky paragraf do të ngrit padi për përcaktimin e përgjegjësive dhe dëmshpërblimit për shpifje.

Publikuesi, redaktori ose personi që zëvendëson atë në mjetin e informimit publik, për shpifje të kryer nga gazetari në atë mjet që është autor i deklaratës, përgjigjen në bazë të parimit të përgjegjësive së supozuar.

Gazetari si autor i deklaratës nuk përgjigjet për shpifje nëse vërteton se shpallja e saj i është urdhëruar nga botuesi, redaktori ose personi që zëvendëson atë ose se përmbajtja e deklaratës së tij është konsiderueshëm e ndryshuar nga redaktori ose personi që zëvendëson atë.

Gazetari si autor i deklaratës nuk përgjigjet nëse ajo ka marrë karakterin e shpifjes me pajisimin e saj duke vënë tituj, nëntituj, fotografi, nxjerrje të pjesëve të deklaratës nga tërësia e saj, lajmërime ose në mënyrë tjetër nga redaktori ose personi që zëvendëson atë.

14 Përveç bazave të përjashtimit të përgjegjësive për shpifje të Nenit 9, paragrafet (2), (3) dhe (4) të këtij Ligji, është përjashtuar përgjegjësia për pretendimin e fakteve të dëmshme për nderin dhe reputacionin e tjetrit që është dhënë për vepër shkencore, letrare ose artistike, në një kritikë serioze, në kryerjen e detyrës zyrtare, profe-

Ligji gjithashtu rregullon dhe mbrojtjen e burimit të informacionit si bazë të parimeve të punës gazetareske. Kështu, parasheh se nga gazetari ose personi tjetër fizik që profesionalisht kryen veprimtari të informimit të publikut, në një procedurë gjyqësore për përcaktimin e përgjegjësisë qytetare për fyerje ose shpifje në pajtim me Ligjin, nuk mund të kërkojë ta zbulojë burimin e vet të fshehtë të informacioneve për faktet për të cilat është i detyruar t'i dëshmojë. Por megjithatë, gjykata mund nga i padituri të kërkojë t'i shpalosë informacionet relevante për arsye të përcaktimit të vërtetësisë së informacionit të publikuar, duke mos identifikuar burimin e informacionit. Në rast se gazetari ose personi fizik që profesionalisht kryen detyrën e informimit të publikut refuzon ta shpalos identitetin e burimit të fshehtë të informacioneve, nuk mund ta merr këtë si pranimin e tij të fajit ose në bazë të kësaj të krijohet konkluzioni se ai nuk ka vërtetuar vërtetësinë e fakteve ose bazueshmërinë e bindjes në vërtetësinë e tyre.

Ligji rregullon dhe përgjegjësinë për publikimin elektronik, edhe pse nuk sqaron se çka nënkuptohet me nocionin “publikim elektronik”. Në pajtim me Ligjin mbi Mediat, publikimi elektronik nuk është media, dhe kështu, vetë Ligji mbi Përgjegjësinë Qytetare për Fyerje dhe Shpifje është i paqartë në këtë çështje.

### **Dëmshtëpërblimi dhe pasojat tjera juridike të përgjegjësive për fyerje dhe shpifje**

Para parashtrimit të padisë për dëmshtëpërblim, personi fizik ose juridik i cili është dëmtuar me

---

sionit gazetaresk, detyrës politike ose tjetër shoqërore, në mbrojtjen e lirisë së shprehjes publike të mendimit ose të drejta tjera gjatë mbrojtjes së interesit publik ose interesa tjera të arsyeuara, nëse: 1) nxjerrjet ose shpallet pretendimi që është përfshirë me kumtesë, vendim ose dokument tjetër të një organi shtetëror, institucioni ose personi juridik, ose është nxjerr gjatë një mbledhjeje publike, në procedurë gjyqësore ose në një manifestim tjetër publik të aktivitetit të organeve shtetërore, institucioneve, shoqatave ose personave juridik, ose nxjerrjet pretendimi që është kumtuar nga dikush tjetër; 2) personit që shpall ose nxjerr pretendimin e tillë i është pamundësuar realizimi i së drejtës për qasje në informacione me karakter publik, që është në kundërshtim me rregullat e qasjes së lirë në informacione, së cilës i referrohet në mbrojtjen e vet; 3) faktet e pavërteta, të përfshira në pretendim, kanë domethënie dytësore në raport me faktet e vërteta me të cilat lidhet pretendimi dhe nuk ndryshojnë rëndësishëm kuptimin e pretendimit të vërtetë, ose 4) në mjetin e informimit publik nxjerrjen fakte që kanë të bëjnë me çështje të interesit publik, duke u thirrur në burime serioze të njoftimeve për vërtetësinë e tyre, sipas të cilave i padituri kishte vepruar me masën e duhur të vëmendjes së duhur, në pajtim me standardet profesioniste të profesionit gazetaresk.

fyerje ose shpifje, ndërmerr masa për zbutje të dëmit me dërgim të kërkesës për kërkim të faljes dhe tërheqje publike të përmbajtjes për të cilën paditësi konsideron se është shpifëse ose fyese. Kërkimin e faljes ose tërheqjen publike, i padituri duhet ta shpall në po të njëjtin vend dhe me po të njëjtin vëllim në mjetin e botuar për informim publik, ose në ueb faqen, ose në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin vëllim, në mjetet elektronike për informim publik ose në ueb faqen, si dhe informacionin ndaj të të cilit reagon (titull, mbititull, nëntitull, tekst në mjetet e shtypura të informimit publik ose në faqen e internetit, lajmërim në një program informativ, kronikë). Kërkimi i faljes ose tërheqja publike e deklaratës shpallet në mjetin e informimit publik, gjegjësisht në faqen e internetit më së voni 48 orë nga dita e dërgimit të reagimit.

Nëse fyerja ose shpifja është bërë nëpërmjet të mjetit për informim publik ose me sistem kompjuterik, i dëmtuari (nënkupton personin fizik ose juridik i cili konsideron se ndonjë përmbajtje e caktuar e menduar për të është shpifëse ose fyese) ka të drejtën e dërgimit të kërkesës për shpallje të përgjigjes, mohimit ose korrigjimit brenda shtatë ditëve nga dita kur ka kuptuar se është shpallur, por jo më vonë se një muaj nga shpallja e saj. Mjeti i informimit publik që ka publikuar përmbajtjen shpifëse ose fyese (tekst, e ngjashëm) shpall mohimin, përgjigjen ose korrigjimin brenda dy ditëve nga dërgimi i kërkesës, në numrin e parë të rradhës, nëse bëhet fjalë për publikime periodike, ose në ndonjë mjet tjetër të informimit publik, nëse bëhet fjalë për një publikim joperiodik. Mohimi, përgjigjeja ose korrigjimi shpallet në të njëjtin vend ose kohë dhe me të njëjtin vëllim si informacioni ndaj të cilit bëhet reagimi (titull, mbititull, nëntitull, tekst në mjete të shkruara të informimit publik ose faqe interneti, lajmërim në një program informativ, kronikë). Publikimi i mohimit ose korrigjimit mund të refuzohet nëse:

- 1) kërkesa nuk është dërguar brenda afatit nga 7 ditë nga dita kur personi ka mësuar se është shpallur përmbajtja, por jo më vonë se një muaj nga shpallja e saj;
- 2) përgjigja përmban fyerje ose shpifje dhe
- 3) përgjigja është në kundërshtim me interesat e personave të tretë, të mbrojtura me ligj.

Një rrethanë mjaft e rëndësishme e parapare me Ligjin mbi Përgjegjësinë Qytetare për Fyerje dhe Shpifje, e që është në kuptimin e përgjegjësisë qytetare për fyerje, është rrethana se Gjykata mund të gjykojë plotësueshëm një shumë të caktuar të dëmit jomaterial për arsye të përmbajtjes së caktuar fyese vetëm në rast se personi kundër të cilit është ngritur procedura gjyqësore nuk ka kërkuar falje dhe nuk ka tërhequr deklaratën fyese ose nëse fyerjen ka përsëritur pas vendimit gjyqësor, me të cilin ndalohet përsëritja e tillë. Kjo do të thotë se mund të nisët procedura gjyqësore kundër një personi të caktuar fizik ose juridik për përcaktimin e përgjegjësisë qytetare për fyerje, ai që padit (personi që konsideron se me një deklaratë, sjellje, publikim të caktuar ose në mënyrë tjetër kundër tij është i shprehur mendimi poshtërues me të cilin është cenuar nderi dhe reputacioni i tij) së pari është i obliguar deri tek personi në fjalë të drejtë një kërkesë për kërkim të faljes dhe tërheqje publike të një deklaratë të caktuar, publikimi të përmbajtjes së caktuar, sjelljes ose veprimit fyerës.

Lartësia e dëmshpërblimit në ara për fyerjen dhe shpifjen është proporcionale me dëmin e shkaktuar mbi reputacionin e të dëmtuarit dhe gjatë caktimit të tij, Gjykata merr parasysh gjitha rrethanat e rastit, e sidomos rrethanat e gjendjes pronësore të të paditurit, si dhe nëse paditësi ka ndërmarrë të gjitha veprimet për zbutjen e dëmit të parapara me Nenet 13 dhe 14 të Ligjit mbi Përgjegjësinë Qytetare për Fyerje dhe Shpifje. I dëmtuari gjithashtu mund të kërkojë nga Gjykata dhe dëmshpërblimin për dëmin material, që konsiston në dëmin real dhe fitimin e humbur. Në kuptimin e shpifjes, dhe për arsye të pakësimit të dëmit, i padituri mund të dëshmojë se ka kërkuar falje, ka ofruar kërkim të faljes ose në mënyrë tjetër ka bërë përpjekje serioze për t'i mënjanuar pasojat dëmtuese të shpifjes.

Ligji mbi Përgjegjësinë Qytetare ka një risi në kuptimin se është caktuar shuma maksimale që guxon të gjykohet plotësueshëm në rast që kundër një gazetari, redaktori të caktuar dhe kundër personit juridik, të jetë përcaktuar përgjegjësia qytetare për fyerje ose shpifje. Për një gazetar, shuma maksimale është 2.000 euro në kundërvlerë denarësh; për një redaktor ose person që zëvendëson atë, shuma deri 10.000 euro në kundërvlerë

denarësh; për personin juridik shuma deri 15.000 euro në kundërvlerë denarësh.

### **Ngritja e procedurës gjyqësore**

Personi fizik ose juridik (përfshirë këtu dhe portali i internetit) që konsideron se një person tjetër i caktuar fizik ose juridik (përfshirë këtu dhe portali i internetit si person juridik), ka kryer fyerje ose shpifje, mund para gjykatës kompetente të ngrit procedurë gjyqësore për përcaktimin e përgjegjësisë qytetare për fyerje dhe shpifje, si dhe dëmshpërblimin e dëmit material dhe jomaterial, që del nga fyerja ose shpifja. Afati i ngritjes së procedurës gjyqësore për përgjegjësi qytetare për fyerje ose shpifje është 3 muaj nga dita kur paditësi ka mësuar ose është dashur të mësojë për përmbajtjen, deklaratën etj. fyese ose shpifëse, si dhe për identitetin e personit që ka shkaktuar dëmin, por jo më vonë se një vit nga dita kur deklarata është dhënë përpara personit të tretë. Sido që të jetë, nëse një portal interneti dëshiron të ngrit padi, ai duhet ta respektojë afatin nga 3 muaj. Gjykata kompetente për ngritjen e procedurës është gjykata aktuale themelore kompetente sipas vendit të kryerjes së fyerjes ose shpifjes. Kjo do të thotë se nëse një person i caktuar fizik ose juridik ka selinë në Manastir, ndërsa ka dhënë deklaratë shpifëse ose fyese në Shkup, kompetente do të jetë Gjykata Themelore Shkup 2 në Shkup.

Gjithashtu, paditësi mund të kërkojë nga Gjykata të urdhërojë që shqiptimin e aktvendimit me të cilin përcaktohet përgjegjësia për fyerje ose shpifje të shpallet me sipas kërkesës së paditësit dhe sipas vlerësimit të Gjykatës, në një gazetë ditore, në llogari të të paditurit, në një hapësirë jo më të vogël se një të tetën nga faqja, diku nga faqja e parë deri tek faqja e pestë e mjetit të shkruar të informimit publik.

### **Praktika gjyqësore në lidhje me aplikimin e Ligjit mbi Shpifje dhe Fyerje, përvojat e palëve të interesuara**

Një redaktor shumëvjeçar i cili për momentin redakton një ueb faqe informative, i cili po ashtu shpesh është cak i sulmeve personale dhe të drejtëpërdrejta publike nga portalet e internetit dhe rrjetet sociale, thotë se me injorimin e përpjekjeve të tij të shumëhershme për adresimin institucional

dhe shfrytëzimin e mekanizmave gjyqësore në lidhje me cenimin e të drejtave të tij, ka humbur besimin e tij në jurisprudencën. “Për fyerjet, jam mësuar se duhet t’i duroj. Por këto ishin dhe shpifje të drejtpërdrejta. Se kemi marrë para, se kemi punuar për shërbime të huaja, madje dhe janë shënuar shuma të parave që kemi marrë, janë numëruar njerëz me të cilët punojmë, shërbime konkrete të huaja të inteligjencës – greke, etj. Të gjitha lëndët i humbëm, me arsyetime që ishin krejtësisht të padrejta, të paturpshme. Dhe kur arritëm dekriminalizimin e fyerjes dhe shpifjes, vendosa se më nuk do të ngre procedura për fyerje dhe shpifje, pasi në këtë Gjykatë dhe në këtë jurisprudencë tanimë nuk kam besim”, thotë redaktori.

Më sa duket, kjo është ndjenja që mbizotëron tek shumica e të intervistuarve në lidhje me aplikimin e Ligjit mbi Përgjegjësinë Qytetare për Shpifje dhe Fyerje. Prezenca e stërmadhe e shpifjeve dhe fyerjeve nga njëra anë, jondëshkueshmëria dhe drejtësia selektive që sipas të intervistuarve ekziston në vend, nga ana tjetër, janë arsytet e mosbesimit të stërmadh të opinionit publik ndaj sistemit gjyqësor.

Gjatë disa debateve publike për këtë çështje, gjykatësit e perceptojnë presionit publik, por dhe të fshehur që bartin me vete lëndët e shpifjes dhe ofendimit. Gjatë debateve publike, gjykatësit shpesh preferojnë që për ato presione të fajësohen mediat dhe politikanët. Analiza e pjesës më të madhe të praktikës gjyqësore jep përshtypje se legjislacioni aplikohet në mënyrë konzistente dhe joselektive, dhe disa gjykatës madje kanë filluar të thirren në praktikën e Gjykatës në Strasburg. Mirëpo, në disa raste është e dukshme se gjykimet bëhen nën presion dhe duke mbajtur anë - kur pjesë e procedurës janë politikanët, sidomos ata në pushtet, por dhe tek disa procese tjera gjyqësore që marrin dimensione politike. Gjithashtu, e dukshme është se një pjesë goxha e madhe e procedurave mbahen midis vetë gazetarëve dhe mediave.

Sa u përket procedurave gjyqësore në të cilat janë përfshirë mediat e internetit, tek gjykatat ekziston dilema nëse mbi ata aplikojnë parimin e përgjegjësisë të shkallëzuar të mediave, redaktorëve dhe gazetarëve, i cili është ndërthurrur në Ligj. Dilema krijohet për shkak të mospërfshirjes

së mediave të internetit nga Ligji mbi Mediat, që disa gjykatës shfrytëzojnë si argument për mosaplikimin e përgjegjësisë të shkallëzuar dhe kufizimit të dëmshpërblimit, që mund të përcaktohet për ndonjë media të internetit, për një redaktor ose gazetar. Nga ana tjetër, për një vendim të tillë të gjykatës mund të ndikojë dhe vetë gjendja faktike në kuptimin e përmbajtjes kontestuese, për shembull, nëse teksti nuk ka autor, dhe në ueb faqen nuk ka impresum ose informacione të qarta për atë se kush mbanë përgjegjësinë redaktuese dhe të autorit. Në raste të tilla, si përgjegjës për përmbajtjen shpifëse ose fyese do të konsiderohet personi fizik ose juridik (gjegjësisht, personi përgjegjës i emëruar nga ai person juridik).

#### *Rasti 1: Një funksionar padit për shpifje për shpenzim jo të synuar të parave buxhetore*

Një person funksionar në administratën shtetërore ka ngritur procedurë gjyqësore për përcaktimin e përgjegjësisë qytetare për shpifje kundër një personi të caktuar – se kishte nxjerrë fakte jo të vërteta, sipas të cilit, funksionari pa synim të qartë për tre muaj kishte shpenzuar një shumë të caktuar parash nga paratë e qytetarëve, për brekë dhe kanotiere sportive. Kjo ishte shpallur në një media të caktuar, por ai nuk ishte paditur. Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup, pas mbajtjes së seancave përgatitore dhe seancave për shqyrtim kryesor, kishte vendosur ta hidhte poshtë kërkesën paditëse të paditësit. Si arsye për këtë Gjykata kishte shënuar se e paditura me gjetjet e saja kishte publikuar dhe një fragment nga Byroja e Furnizimeve Publike, me të cilën, në rastin konkret, Gjykata kishte përcaktuar se janë plotësuar kushtet e Nenit 9, paragrafit 2 – pasi i padituri kishte pasur arsye të bazuar dhe bazë faktike në provat me shkrim – kontratat e cituara për furnizimet publike, për të besuar në vërtetësinë e pretendimeve të tij, të cilat pastaj janë bërë lëndë e kësaj padie për shpifje. Sipas asaj që është përcaktuar, dokumentet me të cilat i padituri kishte disponuar në çastin kur kishte dhënë deklaratat, mbajnë datat e periudhës paraprake dhe publikisht janë shpallur në ueb faqen e Byrosë së Furnizimeve Publike dhe me këtë – të disponueshme për publikun e gjerë. Kjo, aq më tepër, siç është përcaktuar më parë, nga provat tek e paditura nuk ka ekzistuar qëllimi të nxjerrë fakte të pavërteta,

me qëllim t'u bëjë dëm nderit dhe reputacionit të paditësit, por ta informojë publikun për çështje lidhur me punën e Komunës dhe Kryetarit të Komunës, që interesojnë qytetarët dhe janë çështje të interesit publik<sup>15</sup>.

Veç kësaj, deklaratat e të paditurës mund në një pjesë të kualifikohen si mendim i saj subjektiv, që ka bazë të mjaftueshme faktike në raportet mbi kontratat e lidhura për furnizime publike, të shpallura në ueb faqen e Byrosë së Furnizimeve Publike. Ndërkaq, e paditura ka pasur të drejtën që sipas këtyre provave të formojë dhe shprehë mendimin e vet subjektiv, dhe në asnjë rast nga provat e nxjerra nuk është konstatuar se ka pasur për qëllim t'i cenojë të drejtat personale të paditësit për nder dhe reputacion, por kishte shprehur mendimin e vet si këshilltare aktuale dhe funksionare politike, dhe në bazë të lirisë së shprehjes publike dhe politike, e jo me qëllim që të nxjerrë deklaratat fyese dhe shpifëse ndaj të paditurit, me qëllim cenimi i të drejtave të tij personale për nder dhe reputacion.

*Rasti 2: Një funksionar i lartë shtetëror padit për fyerje dhe shpifje në Facebook, Gjykata pjesërisht miraton padinë dhe përcakton dëmshpërblim*

Një person i caktuar në profilin e vet personal në rrjetin social Facebook ka nxjerrë fakte jo të vërteta, të cilat kanë qenë të dëmshme për nderin dhe reputacionin e paditësit, i cili kishte qenë një funksionar i lartë shtetëror, si dhe mendim poshtërues për të, gjë kjo me të cilën kishte cenuar nderin dhe reputacionin e paditësit. Pas ngritjes së padisë dhe procedurës gjyqësore, Gjykata kishte caktuar shkelje të pjesshme të Ligjit, të kryer me

15 Dispozitivi i Aktvendimit të Gjykatës Themelore Shkup 2 në lidhje me përcaktimin e përgjegjësisë qytetare për shpifje: Kërkesa paditëse e paditësit SJ nga S, PËR TË KONSTATUAR përgjegjësi qytetare për shpifje, të nxjerrë nga e paditura MN nga S, kundrejt paditësit SJ, në mënyrë që më datë 15.2.2014, në median elektronike.....mk me faktet e shpallura jo të vërteta se "SJ për tre muaj kishte shpenzuar... euro për qytetarët e K për brekë dhe kanatiera sportive", kishte rënur nderin dhe reputacionin e paditësit, si dhe TË DETYROHET e paditura në emër të dëmit jomaterial për nderin dhe reputacionin e rënur të paditësit SJ t'i paguajë një dëmshpërblim në para, në lartësi nga..... denarë, me interes të detyrueshëm me ligj në lartësi të shkallës referente të BPRM-së që për çdo gjysmëvjetori kishte vazhduar në ditën e fundit të gjysmëvjetorit që i kishte paraprirë gjysmëvjetorit aktual, të rritur për 8 pika procentuale, llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë, e deri në ditën e pagimit përfundimtar, e gjitha kjo brënda një afati nga 15 ditë pas pranimit të aktvendimit, dhe me frikë nga përmbarimi i detyruar, HIDHET POSHTË SI I PABAZË.

disa shpallje të të paditurit në rrjetin social Facebook, të cilat më vonë janë shpallur dhe nga portale tjera dhe të cituara nga veprues tjerë publik. Gjykata kishte gjykuar plotësueshëm dhe një dëmshpërblim jomaterial nga 500.000 denarë, të cilët i padituri duhet t'ia paguajë paditësit, dhe veç kësaj, i padituri detyrohet t'i paguajë dhe shpenzimet gjyqësore<sup>16</sup>. Në arsyetimin e aktvendimit është shënuar se nga gjithë provat e parashtruara gjatë procedurës, pakontestueshëm është përcaktuar se i padituri në disa raste për paditësin kishte nxjerrë ose transmetuar fakte të pavërteta që janë të dëmshme për nderin dhe reputacionin e tij, përderisa ka ditur ose ka qenë i detyruar ta dijë se janë të pavërteta, për shkak të së cilës Gjykata kishte vendosur të përcaktonte përgjegjësi qytetare për fyerje dhe shpifje.

#### 2.2.4. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE DHE MEDIAVE TË INTERNETIT

Gjatë shpalljes së një lajmi të caktuar, interviste ose storjeje hulumtuese, për ndonjë person ose persona, personi juridik duhet të përkujdeset për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.

Në pajtim me Ligjin mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "e dhënë personale" është çdo informacion që ka të bëjë me një person të identifikuar fizik ose person fizik që mund të identifikohet, dhe personi që mund të identifikohet është person identiteti i të cilit mund të konstatohet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, sidomos në bazë të numrit amëz të qytetarit ose në bazë të një ose më tepër simbole specifike për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social.

Nocioni "procesim i të dhënave personale" është çdo operacion ose tërësi operacionesh që

16 Dispozitivi i Aktvendimit të Gjykatës Themelore Shkup 2 Shkup, dhe për arsye të përcaktimit të përgjegjësisë qytetare për fyerje dhe shpifje, të kryer nëpërmjet të rrjetit social Facebook: PJESËRISHT MIRATOHET kërkesa paditëse e paditësit B.B. nga S.

DETYROHET i padituri B.F. t'i paguajë paditësit B.B. nga S. Që në emër të dëmshpërblimit të dëmit jomaterial, shumën nga 500.000,00 denarë, për nder dhe reputacion të cenuar, me interes penal sipas ligjit, llogaritur nga dita e aktgjykimit - 8.5.2014, në lartësi të shkallës referuese të BPRM, që për çdo gjysmëvjetor ka qenë e vlefshme në ditën e gjysmëvjetorit të fundit, që i kishte paraprirë gjysmëvjetorit aktual, rritur për 8 (tetë) përqind deri në pagim, si dhe t'i kompensojë shpenzimet e procesit në shumë nga 73.321,00 denarë, të gjitha këto në afat nga 15 ditë nga dita e pranimit të denimit, me frikë nga përmbarimi i detyruar.



kryhen mbi të dhënat personale në mënyrë automatike ose tjetër, siç janë: grumbullimi, evidencimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, shpallja me transmetim, publikimi ose në mënyrë tjetër bërja e disponueshme, barazimi, kombinimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi.

“Subjekt i të dhënave personale” është çdo person fizik me të cilin kanë të bëjnë të dhënat e procesuara.

Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me kërkesë të qytetarëve, më së shpeshti kishte zhvilluar procedura në rastet në vijim, e me qëllim mbrojtja e të dhënave personale:

- shpallja e fotografive pa pëlqim;
- shpallja e të dhënave të huaja personale në rubrikën SHPALLJE;
- vjedhja e identitetit;
- keqpërdorimi i fjalëkalimit; dhe
- krijimi i profileve të rrejshme.

Ekzistojnë dhe cenime tjera në kuptimin e shpalljes së fotografive nga portalet e internetit pa marrë pëlqimin paraprak nga personi fotografia e të cilit po publikohet. Këtu bëhet fjalë për persona fizik që nuk janë personalitete publike dhe që gëzojnë të drejtën absolute për mbrojtje të privatësisë, që vlen si për mediat tradicionale, ashtu dhe për mediat online. Gjithashtu, ndalohej dhe marrja e fotografive nga rrjeti social Facebook dhe publikimi i tyre në ndonjë portal të caktuar të internetit.

Njëjtë dhe për komunikimin online dhe mediat e internetit vlejné rregullat e mbrojtjes së të miturve. Nëse shpallet fotografia e personit të mitur, është i obligueshëm pëlqimi i prindit/kujdestarit.

Në lidhje me dispozitat kundërvajtëse, gjobat për personin juridik lëvizin nga 1.000 deri 2.000 euro, ndërsa për personin përgjegjës nga 250 deri 600 euro në kundërvlerë denarësh.

### **Praktika e organeve kompetente në zbatimin e Ligjit, përvojat e palëve të interesuara**

Më sa duket, zbatimi i këtij ligji po ec para. Drejtoria ka vendosur një mekanizëm funksional, i cili me shembujt e konstatuar tregon se ka ka-

pacitetin t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve. Megjithatë, në një numër të caktuar të rasteve, siç vërejnë palët e interesuara të intervistuar, reagimi i Komisionit ose ka munguar, ose ka qenë i ngadalshëm.

Kompetenca e Drejtorisë ka të bëjë me fshirjen e profileve të rrejshme të krijuara në FB dhe në rrjetet sociale në përgjithësi, dhe me reagimet e DMDHP për profilet e hakuara. Zakonisht, qytetarët dërgojnë parashtrës në DMDHP, gjegjësisht, kërkesa për fshirje të profileve të rrejshme në FB. Siç thonë në Drejtori, ata janë institucioni i vetëm në rajon që ka realizuar komunikim të drejtpërdrejtë me selinë e FB në Dublin pikërisht për këtë qëllim... Personi që është përgjegjës për të komunikuar drejtpërsëdrejti me Administratorin e FB në Dublin madje dhe në bazë ditore zgjidh sfidat. DMDHP ka formuar ekipin e përgjigjeve të shpejta, i cili menjëherë reagon ndaj kërkesave të këtilla të qytetarëve, pasi pjesa më e madhe e parashtrësve, pra rreth 60%, janë reagime për keqpërdorim të të dhënave personale në rrjetet sociale, gjegjësisht, në portalet e internetit.<sup>17</sup>

#### *Rasti 1: Shpallja e fotografive pa pëlqim, denoncim në Drejtori, fotografitë e larguara*

Një person kishte ngritur procedurë para Drejtorisë për shkak të publikimit të fotografive të tij pa pëlqimin e tij në një nga ueb faqet me karakter argëtues dhe të marketingut, në të cilën shpallen fotografi nga jeta e natës nga disa qytete në vend. Personi i ishte drejtuar adresës së e-mailit të shënuar për kontakt me ueb faqen dhe kishte kërkuar që fotografitë të largohen, megjithatë nuk kishte marrë asnjë përgjigje. Në këtë rast bëhet fjalë për një sferë që është regjistruar jashtë vendit, megjithatë administratori i ueb faqes kryen procesimin në Republikën e Maqedonisë. Drejtoria kishte ndërmarrë gjitha masat përkatëse dhe fotografitë janë mënjanuar madje dhe gjatë rrjedhës së procedurës.<sup>18</sup>

#### *Rasti 2: Fotografia me komente arrin deri tek Gjykata Kushtetuese*

Një person juridik është dënuar nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për arsye se në portalin e internetit në pronësi të personit të dënuar juridik janë shpallur fotografi ku ka pasur

17 Intervistë me një Udhëheqës në DMDHP, gusht, viti 2015

18 [http://www.dzlp.mk/mk/temi\\_6](http://www.dzlp.mk/mk/temi_6)

komente nga persona tjerë. Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kishte kërkuar që fotografitë dhe komentet të largoheshin. Personi juridik kishte dërguar kërkesë deri tek Gjykata Kushtetuese e R. së Maqedonisë, për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit nga Neni 110, alinea 3 e Kushtetutës, që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes publike të mendimit. Në kërkesë personi juridik kishte shënuar se Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kishte cenuar të drejtën e shprehjes publike të mendimit, gjegjësisht, se Drejtoria kishte kërkuar mënjanimin e komenteve dhe fotografive që kanë qenë me interes publik, gjë kjo me të cilën kishte kapërcyer kompetencat e veta dhe kishte caktuar se për çka mund të komentohet dhe për çka nuk mundet, me të cilën i kishte ndarë vetes rolin e censorit të të dhënave publike të shpallura në media. Kështu kishte menduar personi juridik, se Drejtoria po kryente censurimin e mendimit të lirë të shprehjes. Kërkesa ishte hedhur poshtë me vendim për arsye se në pajtim me Kushtetutën e R. së Maqedonisë, mbrojtje të së drejtës së shprehjes mund të kërkojë vetëm një qytetar – person fizik, i cili konsideron se i është shkelur e drejta e shprehjes publike të mendimit.

### *Rasti 3: Numra amëz dhe adresa të shpallura në ueb faqen e një Shoqate*

Një rast tjetër që procedohet nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ky në vijim: një Shoqatë e caktuar Qytetare në ueb faqen e saj kishte shpallur një tekst të padisë të cilën një anëtar i tyre kishte parashtruar në një gjykatë kompetente. Gjatë shpalljes nuk janë redaktuar numri amëz dhe adresa e vendbanimit të anëtarit të tyre, avokatit dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë. Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka konstatuar cenimin e së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale, dhe detyron Kryetarin e Shoqatës që në të ardhmen të përmbahet nga procesimi (publikimi) i të dhënave personale në mënyrë jo të drejtë, pa bazë ligjore në lidhje me qëllimet për të cilat grumbullohen dhe procesohen dhe të mbajë llogari për numrin amëz të qytetarit që të mos jetë panevojshëm i dukshëm, i botuar ose i marrë nga përmbledhja e të dhënave personale, në pajtim me Ligjin.<sup>19</sup>

### *Rasti 4: Numri i telefonit i një gazetareje i publikuar në Facebook, pa pasoja për cenesin*

Pas shpalljes së numrit të telefonit të një gazetare nga faqja e FB të një udhëheqësi të njohur TV, ajo ishte drejtuar tek Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Sipas saj, ajo kishte marrë një përgjigje çuditshme – se ata do t'i shkruajnë Facebook-ut ti largonte ato të dhëna, gjë kjo e cila, sipas gazetares është një gjë të cilën secili që ka profil në Facebook mund ta bëjë – t'i raportojë Facebook-ut se është kjo një e dhënë personale dhe se ajo duhet të largohet që aty. DMDHP i kishte thënë se kjo është e gjitha që ata mund të bëjnë. Më tej, sipas gazetares, DMDHP kishte kontaktuar me Facebook-un, dhe ajo vetë menjëherë kishte shkruar një kërkesë deri tek administratorët e Facebook-ut (kishte bërë “report”), por kjo gjë nuk ishte miratuar dhe nuk kishte dhënë asçfarë rezultati. Nga ana tjetër, siç thotë gazetarja, në çastin kur ajo ishte drejtuar kah Agjencia, dhe i biri i një funksionari të lartë kishte qenë lëndë e nxjerrjes së të dhënave të tij në Facebook, dhe rasti ishte zgjidhur për 2 ditë. “Gjithë ishin angazhuar rreth kësaj dhe menjëherë nga Facebook-u ishin larguar të gjitha fotografitë. Pra, është evidente se kur diçka dëshirohet – kjo mund të bëhet, por kur nuk dëshirohet – do të thonë se do të bëjnë “report” të të dhënës personale, se është shpallur publikisht”, thotë gazetarja.

## **2.2.5. APLIKIMI I LIGJIT MBI PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Përgjegjësia për përmbajtjet diskriminuese të shpallura në internet mund të shqyrtohet edhe nga prizma e Ligjit mbi Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili është pjesë e sistemit juridik të Maqedonisë që nga viti 2010.

Me shpalljen e përmbajtjes, marrjes së tekstit nga një portal tjetër të internetit, ndalohet që teksti të ketë përmbajtje diskriminuese. “**Diskriminimi**”, sipas **definicionit të Ligjit**, është çdo bërje dallimi e paarsyetuar juridike ose faktike, e menjëhershme ose jo e menjëhershme ose veprim i pabarabartë, gjegjësisht lëshim (përfashtim, kufizim ose dhënie të përparësisë) në raport me persona ose grupe që bazohet mbi gjininë, racën, ngjyrën e lëkurës, seksin, përkatësinë një grupi të marginalizuar, përkatësinë etnike, gjuhën,

19 <http://dzlp.mk/sites/default/files/u4/Up1%20br.%2007-217.pdf>

shtetësinë, origjinën sociale, fenë ose bindjen fetare, arsimimin, përkatësinë politike, statusin personal ose shoqëror, pengesat mendore ose trupore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, statusin pronësor ose çfarëdo baze tjetër.

Ligji ndalon në parimet e tij (Neni 3) çfarëdo diskriminimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, thirrje dhe nxitje për diskriminim dhe përkrahje të veprimit diskriminues. Në Ligjin, si sjellje dhe vepra diskriminuese (Neni 5, alinea 4) është definuar çdo sjellje aktive ose pasive të çdo personi, organi publik, personi juridik dhe individëve të jetës private dhe publike, që krijon bazë për privilegjimin ose çprivilegjimin e personit në mënyrë të paarsyetuar, ose që nënshton një person në padrejtësi dhe trajtim degradues në krahasim me të tjerit në një situatë të ngjashme, bazuar në cilëndo nga bazat diskriminuese.

Gjithashtu, me këtë Ligj, si formë diskriminimi dhe torturimi, bëhet i ditur trajtimi poshtëruar (Neni 7), i definuar si cenim i dinjitetit të një personi ose grupi personash që dalin nga baza diskriminuese, e cila ka për qëllim ose është rezultat i cenimit të dinjitetit të një personi të caktuar, nëpërmjet të krijimit ose kërcënimit me ambient, qasje ose praktikë armiqësore, poshtëruese ose frikësuese. Ligji gjithashtu, qartazi tregon për thirrje dhe nxitje në diskriminim (Neni 9) – dhe thotë se për diskriminim do të konsiderohet çdo aktivitet me të cilin një person drejtpërsëdrejti ose tërthorazi thirr, inkurajon, jep udhëzime ose nxit një person tjetër për të kryer diskriminim.

Kompetenca e Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi (Neni 24) është t'i trajtojë ankesat e rasteve të diskriminimit dhe të ndërmarrë iniciativa për veprimin e organeve kompetente për shkelle të Ligjit. Ligji parasheh mjete juridike, gjegjësisht, çdo person që konsideron se i janë cenuar të drejtat për shkak të diskriminimit, mund të parashtrijë lëndë para gjykatës kompetente (Neni 34 e ngjashëm) Përgjegjësia juridike është paraparë për vepra që ftojnë ose nxisin për diskriminim dhe përkrahje e trajtimit diskriminues me baza diskriminuese (Neni 42), për cenim të dinjitetit ose vendosje të ambientit, qasjes ose praktikës kërcënuese, armiqësore, poshtëruese ose frikësuese (Neni 43).

## **Praktika gjyqësore dhe funksionimi i mekanizmave juridike, përvojat e palëve të interesuara**

Deri në çastin e lëshimit të këtij Doracak, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi nuk ka cenuar asnjë procedurë kundër ndonjë portali të internetit, për shkak të tekstit të publikuar diskriminues, e as nuk ka ndonjë procedurë efektive të përfunduar kundër ndonjë portal interneti. Si pas të dhënave të disponueshme të publikuara nga Komisioni, në vitin 2012 kishte patur tetë parashtrësia në përgjithësi për diskriminim në media, dhe në vitin 2013 kishte patur dy parashtrësia<sup>20</sup>.

Në bazë të diskriminimit para Gjykatës si organ i shkallës së dytë, deri tani gjithashtu nuk është hapur formalisht asnjë procedurë për shkelle të dispozitave të këtij Ligji nga ndonjë subjekti në internet.

### **2.2.6. MEDIAT E INTERNETIT DHE LIGJI MBI TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E NGJASHME**

Vepra e autorit, në kuptimin e këtij ligji, është krijim intelektual dhe individual nga lëmi i letërsisë, shkencës dhe artit, shprehur në cilëndo mënyrë dhe formë.

Si vepër autoriale posaçërisht konsiderohen:

- 1) vepra e shkruar (libri, shkresa, artikulli, doracak, broshura, debati dhe vepra tjera me natyrë të njëjtë);
- 2) programi kompjuterik si vepër e shkruar;
- 3) vepra e folur (ligjërrata, folja, biseda dhe vepra tjera me natyrë të njëjtë);
- 4) vepra muzikore, me ose pa tekst;
- 5) vepra dramatike, dramatike-muzikore, koreografike dhe e pantomimës;
- 6) vepra fotografike dhe vepra e krijuar në procedurë të ngjashme me atë fotografike;
- 7) vepra audiovizuale (kinematografike dhe veër tjetër shprehur me fotografi të lëvizshme);
- 8) vepra të artit figurativ (piktura, vizatimi, grafika, skulptura, etj.);

<sup>20</sup> Raporti Vjetor i одишен извештај на KMD për vitin 2013, fq. 8, mund të gjendet në: <http://www.kzd.mk/mk/dokumenti/2013>

- 9) vepra të arkitekturës;
- 10) vepra të artit të aplikuar dhe disenjit, dhe
- 11) vepra hartografikë, plani, skica, vizatimi teknik, projekti, tabela, vepra plastike dhe vepra tjetër me karakter të njëjtë ose të ngjashëm nga lëmi i gjeografisë, topografisë, arkitekturës dhe shkencës.

Si vepër autoriale konsiderohet dhe përpunimi i veprës autoriale, nëse përmbush kushtet e përcaktuara me këtë ligj. Si autor konsiderohet personi fizik që ka krijuar veprën autoriale dhe atij i takon e drejta e autorit mbi veprën e tij autoriale me vetë krijimin e veprës. Çdo autor ka të drejtat absolute morale në vijim:

- 1) të drejtën e pranimit të autorësisë (autori ka të drejtën që emri i tij, pseudonimi ose shënimi tjetër të ceken në çdo ekzemplar dhe gjatë çdo shfrytëzimi publik të veprës);
- 2) të drejtën e shpalljes së parë (të drejtën e shpalljes së parë të veprës së tij autoriale dhe caktimit të kushteve për shpalljen e saj);
- 3) të drejtën e mbrojtjes së integritetit të veprës (autori gëzon të drejtën t'i kundërvihet ndryshimit, deformimit ose gjymtimit të veprës që mund ta dëmtojë personalitetin, nderin dhe reputacionin e tij, si dhe shkatërrimit të veprës së tij);
- 4) të drejtën e anulimit (autori mund t'ia anulojë të drejtën e shfrytëzimit të veprës bartësit të së drejtës së saj materiale nëse shfrytëzimi i mëtejshëm mund të dëmtojë personalitetin, nderin dhe reputacionin e tij).

Si vepra materiale që posedon autori numërohen këto në vijim:

- 1) të drejtën e shumëzimit të veprës;
- 2) të drejtën e lëshimit të veprës në qarkullim;
- 3) të drejtën e shpalljes së veprës dhe
- 4) të drejtën e përpunimit të veprës.

Si autor i veprës, përveç personit fizik, mund të shfaqet dhe personi juridik, gjegjësisht, portali i internetit, dhe kjo konsiderohet si vepër autoriale nga marrëdhënia e punës. Në rast kur vepra autoriale është krijuar nga një punonjës gjatë zbatimit të detyrave të tij të punës ose me udhëzim të pu-

nëdhënësit (në tekstin e mëtejshëm: vepra autoriale nga marrëdhënia e punës), atëherë konsiderohet se të drejtat materiale të autorit të asaj vepra i janë kaluar qartazi punëdhënësit për një periudhë nga pesë vjet pas kompletimit të veprës, nëse me kontratë, ose kontratë pune nuk është përcaktuar ndryshe.

Portali i internetit, në rast të transmetimit të një fotografie të caktuar, veprë audio-vizuale, veprave të artit figurativ, veprës së shkruar, veprës muzikore dhe të veprave tjera autoriale, patjetër duhet shënuar autorin dhe nga ka transmetuar veprën autoriale (hiperlidhje të portalit të internetit, ose në ndonjë mënyrë tjetër).

Në lidhje me këtë problematikë, Qendra për Zhvillimin e Mediave (QZHM) ka publikuar një Doracak mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtave të Ngjashme për mediat elektronike, ku më detajisht janë përpunuar disa pikëpamje lidhur me vetë legjislacionin dhe aplikimin e tij në internet.<sup>21</sup>

Sipas ekspertëve të intervistuar që vijnë nga organizata që merren me media dhe të drejta të autorit, askush nga mediat e internetit nuk është "i pastër" që i pari të fillojë të ndërmerr masa për mbrojtjen e produkteve të veta autoriale. Madje as ata nga ata që konsiderojnë veten të jenë "të pastër" ndaj respektimit të të drejtave të autorit të aktorëve brenda në Maqedoni nuk respektojnë të drejtat e autorit të autorëve të huaj. E drejta e autorit është e tillë, duhet kërkuar leje dhe duhet pyetur për gjithçka.

Përveç kulturës së mosndëshkueshmërisë, edhe këtu është evident mosbesimi i vepruesve të interesuar dhe mosgatishmëria t'i shfrytëzojnë mekanizmat juridik që kanë në dispozicion.

### **Praktika gjyqësore dhe funksionimi i mekanizmave juridik, përvojat e palëve të interesuara**

Në lidhje me marrjen e paautorizuar të gjithpranishme të përmbajtjeve nga ueb faqe të huaja, deri tani ka pasur vetëm disa raste ku media të njohura botërore kanë reaguuar tek ueb faqet e brendshme për marrje të teksteve dhe përkthim të një pjese të tyre të madhe, me poenta, e ngjashëm.

21 <http://mdc.org.mk/avtorsko-pravo-i-srodni-prava-za-elektronski-mediumi>

Deri tani nuk ka ndodhur të niset padi me këtë bazë, por disa proceset që po zhvillohen në vendet e rajonit paralajmërojnë se të drejtat e autorit do të bëhen aktuale në gjykatoret tona në kohën që vjen.

*Rasti 1: Pjesë të teksteve, por dhe seri të tëra të shkresave ndërmerren pa asçfarë pasojash*

Një gazetare pretendon se deri më sot po gjen fragmente të tëra të teksteve të saja që janë inkudruar në ndonjë temë tjetër, por, siç thotë ajo, njeh stilin dhe gjuhën e vet. Në portalet, kur me disa kolegë kishin zbatuar një hulumtimit të vëllimshëm mbi pronësinë në mediat, të gjitha hulumtimet janë marrë nga një portal tjetër, së bashku me përpunimin grafik – grafiqet dhe skemat, me fotografi, pa asçfarë miratimi. Gazetarja thotë se ajo dhe kolegët e saj nuk kanë ngritur padi, por megjithatë kanë kontaktuar redaksitë që bëjnë këtë, të cilët janë përgjigjur se është kjo mënyra në të cilën ata promovojnë dhe përhapin tekstin. Atë që nuk kanë shënuar burimin aspak nuk i prek, edhe pse, pas reagimit, siç thotë gazetarja, shpesh ndodh që t'i ndryshojnë tekstet, por prapëseprapë vendojnë burimin në fund.

*Rasti 2: Kanë shpallur informacion të marrë nga ueb faqja e një gazete, kanë marrë faturë*

Janë ca media që ndalojnë marrjen e lajmeve dhe kur do të vërejnë se dikush kishte marrë lajm nga faqja e tyre madje dhe me citimin e burimit, menjëherë i dërgojnë faturë atij që ka marrë lajmin, pa kërkuar me këtë kërkim të faljes ose largim të tekstit. Një aktivist informon për kësaj rasti kur një portal informativ nga sektori civil kishte shpallur informacionin për të cilin kishte mësuar nga një gazetë ditore. Edhe pse ishte përdorur stil tjetër të renditjes së fjalëve, dhe teksti nuk ka qenë thjeshtë i kopjuar dhe kishte përmbajtur shënimin se informacioni është marrë nga ueb faqja e gazetës, pa asçfarë reagimi, thjeshtë, kishte arritur fatura në adresën e portalit joqeveritar, për detyrimin për përmbajtjen e marrë, e cila ka qenë e ndaluar për marrje. Siç informon aktivisti, nga kompania kanë lënë hapësirë për të bërë negociata ose për ta paguar shumën, ose madje dhe të zgjidhet kontesti në gjykatë.

## 2.2.7. QASJA E LIRË NË INFORMACIONE ME

### KARAKTER PUBLIK

Në veprimtarinë hulumtuese të portalit të internetit, dhe për arsye të marrjes së informacioneve të caktuara, ai mund t'u drejtohet organeve të pushtetit shtetëror dhe organeve dhe organizatave tjera të përcaktuara me ligj, organeve të komunave, Qytetit të Shkupit dhe komunave të Qytetit të Shkupit, institucioneve dhe shërbimeve publike, ndërmarrjeve publike, personave juridik dhe fizik që kryejnë autorizime publike, të përcaktuara me ligj (në tekstin e mëtejshëm: bartësi i informacionit), me kërkesë për qasje të lirë në informacionet me karakter publik. Kjo qasje mund t'i sigurohet me vështrim, kopje, fotokopje ose me regjistrim elektronik.

Kërkesa/formulari për qasje në informacion me karakter publik mund të gjendet në pothuajse të gjitha ueb faqet e institucioneve shtetërore. Në rast të mungesës së kërkesës, ajo mund të merret nga ueb faqja e Komisionit për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik<sup>22</sup>. Gjithashtu në ueb faqen e Komisionit gjendet dhe lista e informacioneve me karakter publik.

Nëse kërkesa është jo e plotë dhe për shkak të kësaj, bartësi i informacionit nuk mund të veprojë, ai do të kërkojë nga kërkuuesi i informacionit që ta plotësojë kërkesën, duke ia dëftuar pasojat nëse nuk bën këtë. Kërkuuesi është i obliguar ta riplotësojë kërkesën në kuadër të tre ditëve nga dita e raportimit të nevojës për riplotësim të kërkesës, gjegjësisht tre ditë nga dita e pranimit të raportimit të nevojës për riplotësim të kërkesës. Nëse kërkuuesi nuk vepron sipas udhëzimeve të poseduesit të informacionit, ai sjell përfundimin me të cilin kërkesa është tërhequr. Kundër këtij përfundimi kërkuuesi ka të drejtën e ankesës deri tek Komisioni për Mbrojtjen e së Drejtës së Informacioneve me Karakter Publik.

Poseduesi i informacionit është i detyruar që menjëherë t'i përgjigjet kërkesës së kërkuuesit, e më së voni në kuadër të 30 ditëve nga pranimi i kërkesës. Nëse kërkuuesi konsideron se informacioni të cilin kishte mësuar nuk është një informacion të cilin ka shënuar në kërkesë nuk është ai të cilin kishte shënuar në kërkesë, mund të kërkojë

22 <http://www.komspi.mk/>

nga poseduesi i informacioneve që t'i mundësojë mësimin e informacionit që kishte shënuar në kërkesë më së voni në kuadër të dhjetë ditëve pas pranimit të kërkesës së përsëritur tek poseduesi i informacionit.

Kundër vendimit me të cilin poseduesi i informacionit ka refuzuar kërkesën, kërkuesi ka të drejtën e ankesës në kuadër të 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit deri tek Komisioni për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik. Komisioni për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik shqyrton ankesën në kuadër të 15 ditëve nga dita e pranimit të ankesës.

Nëse kërkuesi nuk është i kënaqur me vendimin e Komisionit për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik, ai ka të drejtën që në kuadër të 30 ditëve të ngrit kontest administrativ përpara Gjykatës Kushtetuese të R. së Maqedonisë.

### **Zbatimi i Ligjit, roli i Komisionit, përvojat e palëve të interesuara**

Në vitin 2014 deri tek Komisioni, si organ i shkallës së dytë që vendos sipas ankesave nga kërkuessit e informacioneve, janë parashtruar gjithsej 849 ankesa. Gjatë punës tetëvjeçare të Komisionit, numri i ankesave të deklaruara po ndryshon nga viti në vit. Ky ndryshim është i dukshëm dhe në vitin 2014, kur vërehet rritja e numrit të ankesave të parashtruara - 849 në krahasim me 564 ankesa të parashtruara në vitin 2013. Nga numri i përgjithshëm i ankesave të deklaruara, 136 vijnë nga persona fizik, përdërisa 713 ankesa nga shoqata të qytetarëve dhe fondacioni. Numri më i madh i ankesave janë parashtruar në qershor, korrik dhe gusht nga Shoqata ESE nga Shkupi - 498, Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni - 89 dhe Qendra për Komunikime Qytetare, Shkup - 35. Megjithatë, duhet theksuar faktin se edhe në vitin 2014 vërehet rritja e numrit të ankesave në raport me vitin 2013, të parashtruara nga qytetarët - kërkuess të informacioneve.

KOMSPI në raportet e veta konstatoi sukses në punë. Sipas Komisionit, në bazë të të dhënave të shënuara, mund të konstatohet se Komisioni në një numër të madh rastesh pozitivisht ishte

shprehur në favor të kërkuessve të informacioneve dhe kishte sjellë 222 vendime, me të cilat pranon ankesën dhe detyron poseduesin e informacionit ta jep informacionin e kërkuar dhe 30 vendime me të cilat ankesa pranohet dhe lënda kthehet në procedurë të përsëritur përpara organit të shkallës së parë. Komisioni vazhdimisht vazhdon të ndërmjetësojë tek poseduesit e informacioneve, dhe kjo pohohet dhe me 406 përfundime të sjella për ndaljen e procedurës për ankesë, për shkak të dërgimit të informacionit të kërkuar<sup>23</sup>.

Megjithatë, praktika tregon dhe një realitet tjetër. Në të, gazetarët dhe mediat, përfshirë këtu dhe ata që punojnë në internet, kanë vështirësi të mëdha me shfrytëzimin e këtij ligji. Para së gjithash, për shkak të afatit nga 30 ditë, i cili është jofunksional në kontekstin mediatik, dhe pastaj dhe për shkak të mungesës së vullnetit për përgjigje të vërteta tek institucionet, të cilat shpeshherë, edhe kur iu përgjigjen kërkesave të informacioneve, këtë gjë e bëjnë në mënyrë jocilësore dhe formale, duke cituar pjesë të ligjeve, nga vetë kërkesa, duke shmangur kështu që t'i japin përgjigje asaj për të cilën në fakt bëhet pyetja. Ajo që, të jemi të sinqertë, ua mundësojnë dhe vetë gazetarët dhe mediat, të cilët shpesh nuk dinë si saktësisht ta formulojnë kërkesën, lënë hapësirë "manovrimi" për institucionin. Pastaj vijon periudha e kalimit të topit, ankesa në Komision, e cila do ta urdhërojë institucionin për të dhënë përgjigje, pastaj kërkesa e përsëritur, përgjigja e përsëritur, e cila mund përsëri të jetë e pacakatuara. Kështu hyhet në një rreth, i cili demotivon dhe mediat dhe qytetarët për të kërkuar informacione, të cilat dhe me ligj kanë të drejtën t'i mësojnë.

### *Rasti 1: Pret përgjigje për 1 vit në kërkesë të informacionit nga institucioni*

Gazetarja e një medias së internetit deri tek Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit kishte dërguar kërkesa për qasje në informacion dhe tanimë një vit pret përgjigjen e 2-3 kërkesave. Ajo kishte parashtruar ankesë në Komision, i cili pastaj kishte kërkuar nga Sekretariati për t'u përgjigjur. E tërë procedura zgjatë

<sup>23</sup> Raporti Vjetor KOMSPI 2014, fq.5, 9, <http://komspi.mk/wp-content/uploads/2014/07/%D0%93%D0%9E%D0%94%D0%98%D0%A8%D0%95%D0%9D-%D0%98%D0%97%D0%92%D0%95%D0%A8%D0%A2%D0%90%D0%88-2014-%D0%9A%D0%9E%D0%9D%D0%95%D0%A7%D0%9D%D0%9E.pdf>

tepër, thotë gazetarja, dhe ka ndikim demotivues për ata që kërkojnë informacione nga institucionet. “Humb vullnetin, në fund të fundit, ke ngjarje më të rëndësishme aktuale”, thotë ajo.

*Rasti 2: Ligji është jofunksional për mediat, prandaj disa media injorojnë atë*

Në një media interneti kishin pasur praktikën me raste që të parashtrajnë pyetje deri tek ndonjë institucion, dhe të presin përgjigjen për 30 ditë. Në këtë kuptim, thonë, ata me vetëdije injorojnë këtë Ligj. “Çfarë është kjo gazetari nëse informacionin marrin pas 30 ditëve? Paraqitemi drejtpërsëdrejti dhe kërkojmë informacionin, shpesh na tejkalojnë dhe nuk kemi përgjigje”.

## **2.2.8. MEDIAT E INTERNETIT DHE LIGJI MBI MEDIAT**

Të shpeshta janë pyetjet nëse mediat e internetit, si platformë të llojit të vet në të cilën shpalen përmbajtje paraqet media në pajtim me Ligjin mbi Mediat.

Me ndryshimet e Ligjit (Gazeta Zyrtare e R. së Maqedonisë 13/2014), si media konsiderohen mjetet e informimit publik, gjegjësisht, çfarëdo lloji të komunikimit siç janë gazetatat, revistat, programet e radios dhe televizionit, tele-teksti dhe mjetet tjera për informim ditor dhe periodik, përmbajtjet e formuara me redaktim në formën e shkruar, me zë ose me imazh, me qëllim informimi dhe plotësimi i nevojave kulturore, arsimore dhe tjera të publikut të gjerë.

Media nuk janë buletinet, katalogët dhe format tjera të publikimeve, pavarësisht nga mjeti i publikimit, të menduara vetëm për shpallje, për sistemin arsimor ose për korrespondencë afariste, për punën e shoqërive tregtare, institucioneve, shoqatave, partive politike organeve shtetëtare dhe gjyqësore, ndërmarrjeve publike, personave juridik me autorizime publike dhe organizatave fetare.

Si media nuk konsiderohen dhe gazetatat dhe buletinet e institucioneve arsimore “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, publikimet e njësisive të vetëqeverisjes lokale, afishet, fletushkat, prospektet dhe transparentet.

Kështu, në pajtim me atë që u tha më herët, portalet e internetit, në pajtim me Ligjin në fuqi

mbi Mediat, nuk konsiderohen si media, ndërsa dispozitat e këtij Ligji të cilat vlejnë për të gjitha mediat, aplikohen në rregullimin e funksionimit të tyre.<sup>24</sup>

## **2.3. MARRËDHËNIET AFARISTE DHE TË PUNËS**

### **2.3.1. THEMELIMI I MEDIAVE TË INTERNETIT NGA SHOQËRITË TREGTARE**

Së pari, nëse qëllimi është të realizohet fitim nga media e internetit, duhet të themelohet një shoqëri tregtare, e cila, nëpërmjet të medias së internetit do të funksionojë në treg. Shoqëria themelohet në pajtim me Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare dhe mund të themelohet në njërin nga format në vijim:

- shoqëri komandite publike (SHKP);
- shoqëri komandite (SHK);
- shoqëri me përgjegjësi të kufizuar<sup>25</sup> (SHPK dhe SHPKNJP) (nëse themelohet nga një person, emërtohet shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të një personi);
- shoqëri aksionare (SHA); dhe
- shoqëri komanditore me aksione (SHKA).

Në qarkullimin juridik në Maqedoni, pothuajse çdoherë personat fizik, për të kryer veprimtarinë tregtare të portalit të internetit, vendosin të themelojnë shoqëri tregtare në formën – shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK/SHPKNJP). Arsyeja më e shpeshtë për këtë është se SHPK/SHPKNJP janë format e shoqërive tregtare ku themeluesi/themeluesit përgjigjen për obligimet e shoqërisë në lartësi të depozitës së tyre, gjegjësisht, përgjegjësia që themeluesit kanë në kuptimin e plotë të obligimeve ndaj shoqërisë është e kufizuar.

Shoqëria (kompania) themelohet duke vënë depozitën nga aksionari/aksionarët në kapital bazë të shoqërisë. Kapitali bazë i shoqërisë ar-

<sup>24</sup> Ligjet e mediave dhe shpërbimeve mediatike audiovizuale mund të merren në [www.avmu.mk](http://www.avmu.mk)

<sup>25</sup> Dallimi midis SHPK (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) dhe SHPKNJP (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar një personi) gjendet në numrin e personave fizik ose juridik që paraqiten si themelues. Nëse është një, atëherë forma është SHPKNJP, e nëse janë dy ose më tepër themelues, atëherë forma është SHPK.

rin minimumin e 5.000,00 eurove në kundërvlerë denarësh. Depozita në kapitalin bazë mund të jetë depozitë në para ose jo në para. Depozita jo në para përbëhet nga sende që janë në pronësi të themeluesit/themeluesve që depoziton atë. Depozita individuale nuk mund të jetë më e ulët se 100 euro në kundërvlerë denarësh. Depozita patjetër duhet të shprehet në numër të plotë, me në numër që mund të pjesëtohet me numrin 100. Shoqëria mund të themelohet dhe pa pagimin e kapitalit bazë, me të cilën themeluesit/aksionarët janë të obliguar ta vënë depozitën e tyre në kapitalin bazë brenda 1 – një viti nga dita e shpalljes së regjistrimit të shoqërisë në ueb faqen e Regjistrat Qendror të R. së Maqedonisë.

Në Nenin 29 të Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare të R. së Maqedonisë numërohen subjektet që nuk mund të themelojnë një shoqëri tregtare.<sup>26</sup>

Në klasifikimin nacional të veprimtarive, në grupin 72.40/0 Bazat e të dhënave, protalet e internetit janë në nëngrupin 63.12, me të cilën lejohet realizimi i fitimit sipas kësaj veprimtarie tregtare.

Themelimi i SHPK/SHPKNJP bëhet me parashtrimin e dokumenteve vijuese përpara agjen-

tit të regjistrimit të autorizuar për themelimin e shoqërive tregtare:

1. Deklarata e themelimit/Kontrata e themelimit<sup>27</sup> - dokumente këto në të cilat duhet të shënohet emri i shoqërisë, selia, themeluesit, drejtori dhe dispozita tjera që janë standarde për rregullimin e marrëdhënieve midis shoqërisë, themeluesit/themeluesve dhe drejtorit;
2. Deklarata e themeluesit sipas Nenit 29 dhe 32 të Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare;
3. Deklarata e drejtorit të shoqërisë sipas Nenit 29, 32, 183 dhe 231, paragrafit 4 të Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare;
4. Deklarata sipas Nenit 7 të Rregullores për autorizimin e agjentit të regjistrimit, nënshkruar nga aksionari;
5. Deklarata sipas Nenit 7 të Rregullores për autorizimin e agjentit të regjistrimit, nënshkruar nga drejtori.

## Drejtimi i shoqërisë

Shoqërinë tregtare SHPK/SHPKNJP mund të drejtojë një drejtor, apo më shumë drejtorë, i cili zgjidhet nga aksionari/aksionarët. Si drejtor mund të zgjidhet një person fizik, i cili posedon aftësi pune. Drejtor mund të jetë dhe themeluesi i shoqërisë. Autorizimet e drejtorit përcaktohen me kontratën e shoqërisë. Nëse me kontratën e shoqërisë nuk janë përcaktuar autorizimet e drejtorit, ai mund t'i ndërmerr të gjitha punët dhe veprimet juridike që kanë të bëjnë dhe janë të zakonshme për kryerjen e punëve dhe të cilat janë në interes të shoqërisë. Në marrëdhëniet me persona të tretë, drejtori është i autorizuar që të veprojë nën të gjitha rrethanat në emër të shoqërisë, me përjashtim të autorizimeve që, sipas këtij Ligji dhe kontratës së shoqërisë, mbajnë aksionarët.

Nëse janë zgjedhur më tepër drejtorë, gjithë drejtorët e shoqërisë kanë autorizime dhe të drejta të barabarta në lidhje me kryerjen e punëve të shoqërisë, përveç nëse me kontratën e shoqërisë nuk është përcaktuar ndryshe.

<sup>26</sup> 1) shoqëritë tregtare llogaria e të cilave e hapur tek cilido bartës i qarkullimit pagesor është e bllokuar dhe personat që janë anëtarë të organit të drejtimit, organit të mbikëqyrjes, gjegjësisht, janë drejtorë të këtyre shoqërive, përderisa zgjatë bllokimi i llogarisë së shoqërisë ose përderisa nuk niset procedura e likuidimit ose bankrotimit të saj; 2) shoqëritë ndaj të cilave është hapur procedura e bankrotimit, përderisa zgjatë procedura; 3) personat që janë anëtarë të organit të drejtimit, organit të mbikëqyrjes, gjegjësisht drejtorë të shoqërive tregtare të cilëve në një procedurë të përcaktuar me ligj u është shqiptuar ndalimi i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës, përderisa zgjatë ndalimi; 4) personi që është aksionari në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) ose në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të themeluar nga një person (SHPKNJP), llogaria e të cilit është bllokuar, përderisa zgjatë bllokimi i llogarisë së shoqërisë ose përderisa ndaj shoqërisë nuk hapet procedura e likuidimit ose bankrotimit dhe 5) aksionarët, drejtorët dhe anëtarët e organit të drejtimit dhe organit të mbikëqyrjes së shoqërive për të cilat, në pajtim me Nenin 552-b të këtij Ligji është filluar procedura e fshirjes, përderisa zgjatë kjo procedurë dhe në kuadër të një afati nga tre vite nga dita e shpalljes së fshirjes së shoqërisë në ueb faqen e Regjistrat Qendror, përveç themeluesit, apo aksionarët që janë organizata ndërkombëtare financiare, anëtare e të cilave është dhe Republika e Maqedonisë dhe pjesëmarrja e të cilave në kapitalin bazë të shoqërisë është nën 50% 6) personat për të cilët me vendim efektiv është përcaktuar se kanë kryer veprë penale – bankrot të rrejshëm, shkaktim të bankrotimit me punë të pandërgjegjshme, keqpërdorim të procedurës së bankrotimit, dëmtim ose privilegjim të kreditorëve dhe u është shqiptuar ndalimi i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës, përderisa zgjatën pasojat juridike të ndalimit.

<sup>27</sup> Deklarata e themelimit nënshkruhet në rast kur themeluesi është një person (SHPKNJP); Kontrata e themelimit nënshkruhet kur janë dy ose më tepër themelues (SHPK).



Shoqërinë në raportet me personat e treta përfaqëson drejtori. Drejtori firmos kështu që pas shënimit të firmës së shoqërisë, ai shënon statusin e vet të drejtorit dhe vë firmën e vet. Nëse shoqëria ka më tepër se një drejtor, shoqërinë e përfaqësojnë gjithë drejtorët, përveç nëse me kontratën e shoqërisë nuk është përcaktuar ndryshe. Deklarata e vullnetit ndaj shoqërisë e shprehur ndaj njërit nga drejtorët konsiderohet se është bërë ndaj gjithë drejtorëve. Drejtori është i obliguar t'i respektojë kufizimet e autorizimit për përfaqësim, të caktuara në kontratën e shoqërisë, në vendimin e mbledhjes së aksionarëve ose në vendimin e sjellë me korrespondencë. Drejtori që ka ditur se ndërmerr një veprim në emër të shoqërisë pa pasur autorizim për këtë, i detyrohet shoqërisë personalisht për dëmin që ka dalë nga kjo.

Personi juridik është i obliguar që për çdo vit të kaluar afarist, nga 1 janari deri më 31 dhjetor të dërgojë llogari vjetore për punën e shoqërisë.

### 2.3.2. MEDIAT E INTERNETIT TË THEMELUARA NGA SHOQATA TË QYTETARËVE

Një formë tjetër e mbajtjes së medias së internetit është me themelimin e shoqatës së qytetarëve, në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Shoqatat dhe Fondacionet.

Për dallim nga shoqëritë tregtare (SHPK/SHPKNJP), ku themeluesit themelojnë atë me qëllim realizimi i fitimit për vete, tek portalet e internetit që janë shoqata, qëllimi është avancimi i qëllimeve të caktuara për të cilat shoqata konsideron se themeluesit themelojnë atë me qëllim për të realizuar fitim për vete, tek portalet e internetit që janë shoqata, qëllimi është avancimi i qëllimeve të caktuara për të cilat shoqata konsideron se ka nevojë në vetë shoqërinë. Njëri nga parimet e shoqatave të qytetarëve është parimi i jofitimprurjes, përcaktuar me Nenin 12 të Ligjit mbi Shoqatat dhe Fondacionet. Kjo nënkupton se shoqata nuk mund të themelohet për shkak të marrjes së fitimit. Por, ata nuk mund të marrin fitim nëse veprimtaria e tyre është e lidhur me qëllimet e përcaktuara me Statutin e Shoqatës. Nëse shoqata realizon fitim, ai patjetër duhet të shfrytëzohet për realizimin e qëllimeve të përcaktuara me Statutin e Shoqatës. Fitimi i realizuar nuk mund të shpërndahet midis themeluesve, anëtarëve, anëtarëve të organeve,

drejtorëve, të punësuarve, ose cilitdo personi që ka lidhje me ata. Por kjo nuk do të thotë se me fitimin e realizuar nuk mund të mbulohen shpenzimet aktuale, si për shembull, rrogat e të punësuarve, pasi personat janë punësuar për t'i realizuar qëllimet e shoqatës.

Një shoqatë të qytetarëve mund të themelojnë së paku 5 – pesë persona juridik dhe persona fizik me aftësi pune, nga të cilët 3 – tre duhet pasur vendbanim ose vendqëndrim në territorin e R. së Maqedonisë. Veprimtaria me prioritet /kodi kryesor i fitimit të shoqatave është: 94.99 – Veprimtaritë e organizatave tjera në bazë të anëtarësimit, jo të përmendura tjetërkund.

Shoqata themelohet gjatë një kuvendi themelues, në të cilin sillen akti i themelimit, programi, statuti dhe zgjidhen organet e shoqatës. Në Ligjin mbi Shoqatat dhe Fondacionet më gjerësisht është shënuar se çka duhet të përmbajë, individualisht, secili nga aktet e shënuara të shoqatës. Në gjithë nga këto dokumente të shënuara, numërohen qëllimet që shoqata dëshiron t'i arrijë. Ato nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e R. së Maqedonisë. Në lidhje me portalet e internetit, qëllime më të shpeshta të shoqatave janë mbrojtja dhe zhvillimi i demokracisë, shoqëria civile dhe mendimi publik; zhvillimi i etikës dhe moralit; zhvillimi i marrëdhënieve ndëretnike; avancimi i standardeve evropiane; përmirësimi i profesionit gazetaresk në R. e Maqedonisë, etj.

Organet e shoqatës janë këto në vijim:

- Kuvendi;
- Përfaqësuesi i Shoqatës (shpesh i quajtur Kryetar);
- Bordi Drejtues (është opsionale, varësisht nga mënyra e strukturës organizative-kierarkike që shoqëria dëshiron ta vendos);
- Bordi Mbikëqyrës (është opsionale, varësisht nga mënyra e strukturës organizative-kierarkike që shoqëria dëshiron ta vendos).

Zgjedhjet e financimit të shoqatës janë paraparë me Nenin 48 të Ligjit, i cili shënon: “*Organizatata grumbullojnë mjetet e financimit nga anëtarësia, depozitat hyrëse, kontributet vullnetare, donacionet, dhuratat (në para, mallra, të drejta pronësore), trashëgimi, legatë, veprimtari me të cilat arrihet fitimi, qiramarrje dhe qiradhënie, si dhe të ardhura*

*nga investime, dividenda, interesa, hua dhe të ardhura tjera në pajtim me ligjin dhe Statutin.*“

Personi juridik është i obliguar që për çdo vit të akluar afarist nga 1 janari deri më 31 dhjetor të dërgojë llogari vjetore për punën e shoqatës.

### 2.3.3. REGJISTRIMI I DOMENIT

Për kryerjen e veprimtarisë së portalit të internetit, shoqëria tregtare/shoqata duhet të merr me qira një domen interneti prej njërit nga agjentët e autorizuar të internetit për regjistrimin e domeneve. Të drejtën për të regjistruar domen *.mk* kanë gjithë personat fizik dhe juridik. Të drejtën e regjistrimit të domenit *org.mk* kanë organizatat jofitimprurëse, shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet. Të drejtën për të regjistruar domen *com.mk*, *net.mk* dhe *inf.mk* kanë gjithë shoqëritë tregtare dhe personat juridik të regjistruara për të kryer veprimtari ekonomike.

Gjatë regjistrimit të domenit, shoqëria tregtare/shoqata e qytetarëve duhet të shënojë një kontakt administrativ dhe një kontakt teknik. Kërkesa për regjistrimin e domenit mund të merret nga ueb faqet e agjentëve që ofrojnë regjistrim të domenit, lista e të cilëve gjendet në ueb faqen e MARnet<sup>28</sup>.

#### Zbatimi i rregullave, përvojave të palëve të interesuara

MARnet është një institucion publik që kryen veprimtari me interes publik. Është themeluar me votimin e Ligjit për Themelimin e Rrjetit Maqedonas Akademik Hulumtues – MARnet dhe shpalljen e tij më datë 20.9.2010 në Gazetën Zyrtare të RM-së nr. 124. Me këtë, MARnet merr statusin e personit juridik me regjistrimin e tij në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë. Me emërtimin e drejtorit, MARnet zyrtarisht fillon punën.

Mes tjerash, MARnet është i obliguar për mirëmbajtjen dhe drejtimin e DNS kombëtare, përfaqësimit dhe anëtarësimin ndërkombëtar; mbajtjen e politikës dhe zhvillimin e rrjetit akademik kombëtar.

Drejtimin e MARnet kryen Bordi Drejtues. Anëtarët e Bordit emërtohen dhe shkarkohen nga Qeveria e R. së Maqedonisë. Anëtarët e Bordit Drejtues emërtohen sipas parimit të ekspertizës

28 <http://marnet.mk/domeni/registrari/lista-na-registrari/>

dhe kompetencës dhe parimit të përfaqësimit përkatës dhe të drejtë<sup>29</sup>.

Në Maqedoni, kontratë me MARnet për kryerje të funksionit të regjistratorëve të domeneve kanë lidhur 19 kompani. Në ueb faqen e MARnet janë të disponueshme dhe informacionet mbi sistemin e regjistratorëve të domeneve tek ne<sup>30</sup>.

Në bazë të Nenit 10 paragrafit 1 alinesë 8 dhe 9 të Ligjit mbi Themelimin e Rrjetit Maqedonas Akademik Hulumtues MARnet (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 124/10 e datës 20.9.2010), Bordi Drejtues i MARnet gjatë seancës së mbajtur më datë 21.5.2014 solli *Rregulloren mbi organizimin dhe drejtimin e domenit cilësor .mk dhe .mkd*<sup>31</sup>. Me këtë Rregullore rregullohen çështjet e organizimit dhe drejtimit të domenit cilësor të Maqedonisë *.mk* dhe domenin cilësor të Maqedonisë *.mkd*, llojet e nëndomeneve në domenet *.mk* dhe *.mkd* dhe shfrytëzimi i tyre, emrat e nëndomeneve, regjistrimi dhe fshirja e nëndomeneve në domenet *.mk* dhe *.mkd*, të drejtat dhe detyrimet e shfrytëzuesve të nëndomeneve, mënyra e referimit të zghidhjes së kontesteve dhe çështjeve tjera në lidhje me udhëheqjen e domeneve cilësore të Maqedonisë dhe nëndomeneve të regjistruara në domenet *.mk* dhe *.mkd*.

Sipas Nenit 5 të kësaj Rregulloreje, në domenin cilësor *.mk* organizohen:

- Domeni primar *.mk*, dhe
- Domenet dytësore 1. *gov.mk* 2. *edu.mk* 3. *org.mk* 4. *com.mk* 5. *net.mk* 6. *inf.mk*

Në nenet e mëtejshëm të Rregullores sqarohet kategorizimi i domeneve dhe nëndomeneve dhe mënyra e marrjes dhe regjistrimit të tyre në ueb faqe sipas emrit të caktuar.

Hapja e ueb faqes dhe regjistrimi i domenit në Maqedoni është një gjë relativisht e lehtë dhe paraqet mundësi që çdo vit e shfrytëzojnë mijëra ueb faqe të reja që shfaqen në hapësirën maqedonase të internetit. Kërkesa për regjistrim të domenit ose ndryshim të të dhënave në regjistrim është lehtë e qasshme dhe e dukshme në faqen e MARnet<sup>32</sup>.

29 Законот, надлежностите и мисијата на МАРнет се достапни на: <http://marnet.mk/za-nas/>

30 <http://marnet.mk/domeni/registrari/sistem-za-registracija/>

31 <http://marnet.mk/doc/pravilnik-mk-mkd.pdf>

32 <http://marnet.mk/doc/baranje-za-domen.pdf>

Sipas të dhënave në MARnet, në Maqedoni janë regjistruar 23.937 domene (domenet 7.965 .com.mk; 13.615 .mk; 614 .mkd, 821 .org.mk; 167 .net.mk; 15 .inf.mk; 340 .gov.mk; 259 .edu.mk). Mirëpo, kjo nuk do të thotë se në vend ka mbi 23.000 ueb faqe të regjistruara, aq sa ka domene, sepse ekzistojnë ndërmarrje mediatike dhe të tjera, persona fizik dhe juridik të cilët janë pronarë të dy ose më tepër domeneve. Për shembull, një pjesë e mirë e mediave të cilat më parë shfrytëzonin Internet adresat me ekstenzion .com.mk më vonë hapën deomene me ekstenzionin .mk, kurse që të dy domenet të çojnë deri te ueb faqja e njëjtë, përkatësisht lokacioni i njëjtë në internet. Përveç kësaj, ka shumë domene që nuk janë aktive, të cilët kanë funksionuar më parë si pjesë e aktiviteteve parciale dhe projektuese të personave të ndryshëm fizik dhe juridik në vend, ose domene për të cilat planifikohet të jenë aktive në të ardhmen, por të cilat akoma nuk janë aktive.

Sa u përket procedurave të regjistrimit të domenit, asnjëri nga të intervistuarit nuk shprehu vërejtje në lidhje me funksionimin e organeve dhe mekanizmave kompetent.

#### **2.3.4. LIGJI PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE MEDIAT E INTERNETIT**

##### **Formimi i marrëdhënies së punës**

Në pjesën e rregullimit të të drejtave dhe obligimeve të të gjithë të punësuarve në mediat e internetit vlejnë dispozitat e Ligjit ekzistues për marrëdhënie pune.

Si çështje e parë paraqitet çështja e formimit të marrëdhënies së punës së të punësuarve. Me nënshkrimin e marrëveshjes për punësim formohet marrëdhënie pune mes punëtorit dhe punëdhënësit. Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë në bazë të kryerjes së punës nga marrëdhënia e punës dhe përfshirë në sigurimin e obligueshëm social në bazë të marrëdhënies së punës, fillojnë të realizohen në ditën kur punëtori fillon punën, të kontraktuara në marrëveshjen e punës.

Punëdhënësi ka për obligim të dorëzoj lajmërim/çlajmërim (formular elektronik M1/M2 i shtypur nga sistemi i Agjencisë së punësimit të R. së Maqedonisë) për punëtorin në sigurimin e obl-

ligueshëm social (pensional dhe invalidor, sigurim shëndetësor dhe sigurim në rast të papunësisë), në përputhje me rregullat e posaçme, në Agjencinë për punësim të R. së Maqedonisë, në mënyrë elektronike apo në Agjenci me dorëzimin e formularit PPR, autorizim të personit të autorizuar me listë për personat që i lajmëron/çlajmëron, ku përmenden emri, mbiemri dhe numri amë si dhe numri i marrëveshjes për punësim dhe data e lidhjes së marrëveshjes për punësim, një ditë para se i punësuarit të filloj me punë, ndërsa për çështje urgjente dhe që s'mund të shtyhen, të paktën 1 orë para se i punësuarit të filloj me punë.

Fotokopje të vërtetuar nga formulari apo certifikatë nga regjistri kompjuteri i sistemit informativ i Agjencisë i jepet punëtorit në afat prej 3 ditëve nga dita kur i njëjti fillon me punë. Agjencia e punësimit në R. e Maqedonisë, Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Maqedonisë si dhe Fondi për sigurim shëndetësorë i R. së Maqedonisë janë të obliguar të mbajnë dhe të ruajnë në mënyrë afatgjate evidencën e lajmërimeve dhe ç'lajmërimeve në sigurim social dhe me kërkesë të personit t'i japin të dhëna për gjendjen dhe ndryshime në lidhje me sigurimin social të punëtorit.

Agjencia e punësimit në R. e Maqedonisë, Fondi për sigurim pensional dhe invalidor si dhe Fondi për sigurim shëndetësor i R. së Maqedonisë, bëjnë këmbim të të dhënave në lidhje me sigurimin social.

Nëse data e fillimit të punës nuk është e përcaktuar në marrëveshjen për punë, si datë për fillimin e punës konsiderohet dita e ardhshme e datës së nënshkrimit të marrëveshjes për punë ndërsa punëtori paraqitet në Agjencinë e punësimit të R. së Maqedonisë në datën e nënshkrimit të marrëveshjes së njëjtë.

Punëtori mund të filloj punën para se të lidh marrëveshje për punë dhe para se punëdhënësi ta lajmëroj në sigurimin e obligueshëm social. Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë në bazë të kryerjes së punës nga marrëdhënia e punës dhe përfshirja në sigurimin e obligueshëm social në bazë të marrëdhënies së punës, fillojnë të realizohen me ditën kur punëtori fillon punën, gjithashtu, edhe në rast se në atë, për shkaqe të arsyeshme nuk do ta filloj punën. Shkaqet të arsyeshme sipas këtij ligjit,

për shkak të cilave punëtori nuk fillon me punë në ditën që është përmendur në marrëveshje e punës, janë rastet kur punëtori mungon nga puna me shkaqe të vërtetuara me ligj, marrëveshjen kolektive dhe marrëveshjen për punësim. Nëse punëtori pa arsye nuk vjen në punën në ditën e parë të punës sipas marrëveshjes, do të konsiderohet se nuk ka formuar marrëdhënie pune. Nëse punëdhënësi pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, në afat prej 8 ditëve nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nuk e çajmëron punëtorin nga sigurimi i obligueshëm social, çajmërim të punëtorit mund të kryhet me kërkesë të punëtorit në bazë të procesverbalit të dorëzuar më herët nga inspektorati i punës deri te Agjencia për punësim në R. e Maqedonisë.

Marrëveshja e punës mund të jetë në kohë të caktuar dhe të papërcaktuar. Nëse lidhet marrëveshje në kohë të caktuar, me ndërprerje apo pa ndërprerje, ajo vazhdon 5 vite. Marrëveshje për punë në kohë të caktuar për ndërrimin e ndonjë punëtorit i cili mungon përkohësisht mund të lidhet pas kthimit të punëtorit të munguar. Me përjashtime të caktuara, marrëdhënia e punës e bazuar me marrëveshje për punë me kohë të caktuar mund të transformohet në marrëdhënie pune me kohë të papërcaktuar dhe para përfundimit të afatit prej 5 viteve, nëse punëtori punon më shumë se 2 vite në vend pune që është liruar në bazë të pensionimit apo ndonjë baze tjetër dhe për të cilin vend janë siguruar mjete financiare, nëse punëdhënësi vërteton se ka nevojë afatgjate për punëtor, me kushte dhe mënyrat e vërtetuara me ligj.

### **Përmbajtja e marrëveshjes për punësim**

Me Marrëveshjen për punësim hollësisht rregullohen marrëdhëniet mes punëdhënësit dhe punëtorit ndërsa elementet që ai duhet t'i përmbaj janë këto në vijim:

1) të dhënat për palët e kontraktuara, vendbanimi i tyre gjegjësisht adresa; 2) data e fillimit të punës; 3) emri i vendit të punës gjegjësisht të dhënat për llojin e punës për të cilën punëtori lidh marrëveshje për punësim, me përshkrim të shkurtër të punës që do ta kryen sipas marrëveshjes për punësim; 4) dispozita për obligimin e punëdhënësit ta informoj punëtorin për vendet e rrezikshme të punës dhe kualifikimet e posaçme profesionale apo njohuritë ose vëzhgim

i nevojshëm i posaçëm mjekësor, në përputhje me ligjin, me përmendjen e rreziqeve të veçanta që sipas dispozitave ligjore mund të jenë pasoja nga puna; 5) vendi i kryerjes së punës. Nëse nuk përmendet vendi i saktë, konsiderohet se punëtori e kryen punën në selinë/adresën e punëdhënësit; 6) kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, kur është lidhur marrëveshja për kohë të caktuar; 7) rregull për atë se a bëhet fjalë për marrëdhënie pune me orar të plotë apo gjysmë të plotë; 8) rregull për orar pune ditore apo javore dhe rregullimin e orarit të punës; 9) rregull për lartësinë e pagës elementare që i takon punëtorit për punën e kryer sipas ligjit, marrëveshje kolektive dhe marrëveshje për punësim; 10) rregull për kompensimet tjera që i takon punëtorit për kryerjen e punës sipas ligjit dhe marrëveshjes kolektive; 11) rregull për pushim vjetor gjegjësisht mënyra e rregullimit të pushimit vjetor dhe 12) përmendjen e akteve të përgjithshme të punëdhënësit ku përmenden kushtet për punë të punëtorit.

Ndryshime në marrëveshjen për punësim mund të propozohen nga ana e punëdhënësit apo nga ana e punëtorit. Ndryshimet e marrëveshjen për punësim bëhen ma aneksim të marrëveshjes për punësim. Aneksi i marrëveshjes për punësim lidhet në të njëjtën formë si edhe marrëveshja për punësim, sipas ligjit. Ndryshimet e marrëveshjes për punësim mund të bëhen nëse të dy palët arrijnë pajtim për këtë.

### **Obligimet e punëtorit**

Punëtori është i obliguar me përgjegjësi ta kryej punën në vendin e punës për të cilin ka lidhur marrëveshje për punësim, në kohë dhe vend që janë përcaktuar për kryerjen e punës, duke respektuar organizimin e punës dhe aktivitetin e punës të punëdhënësit.

Punëtori është i obliguar që t'i respektojë dhe zbatojë rregullat për mbrojtje gjatë punës, që të mbrojtë jetën dhe shëndetin e tij si dhe jetën dhe shëndetin e personave tjerë. E drejtë dhe obligim i çdo punëtorit është që të kujdeset për sigurinë e tij personale dhe sigurinë e personave tjerë që punojnë me të, në përputhje me trajnimet dhe instruksionet që ia ka treguar punëdhënësi, të njihet me masat e sigurisë së shëndetit gjatë punës dhe të jetë i trajnuar për zbatimin e tyre, në përputhje me rregullat për siguri dhe shëndet gjatë punës.

Punëtori ka të drejtë të refuzojë kryerjen e ndonjë pune të caktuar nëse i ekspozohet ndonjë rrezikut për shëndetin apo jetën e tij, kur nuk janë zbatuar masat e sigurisë dhe të kërkoj evitimin e tyre.

### **Obligimet e punëtorit të ruaj sekretet e punës**

Ajo që është e rëndësishme për punëtorët në mediat e internetit (sikur edhe në të gjitha mediat) janë obligimet ligjore për ruajtjen e sekretit të punës. Në këtë mënyrë, punëtori s'mund t'i shfrytëzojë për nevojat e tija personale apo t'ia dorëzojë ndonjë personit të tretë të dhënat që konsiderohen si sekret pune i punëdhënësit, i cili si të tilla me akt të posaçëm do t'i përcaktojë punëdhënësi dhe që i janë besuar punëtorit apo me të cilat është njoftuar në mënyrë tjetër. Punëtori është përgjegjës për publikimin e sekretit të punës nëse e ka ditur apo e ka pasur të patjetërsueshme të dijë për këtë veçori të të dhënave.

Secili punëtor i cili vjen në kontakt me materialet, informacionet apo të dhënat që janë të klasifikuara është i obligueshëm që të ruajë fshehtësinë e tyre. Përfaqësuesit e punëtorëve dhe gjithë ekspertëve që u ndihmojnë nuk guxojnë punëtorëve apo palëve të treta t'u zbulojnë çfarëdo informacioni që është interes pune i punëdhënësit e që janë thënë në besim. Obligimi i këtillë ngel në fuqi edhe pas përfundimit të mandatit të tyre.

Në raste të caktuara dhe sipas kushteve dhe kufizimeve sipas ligjit, mund të konfirmohet se punëdhënësi nuk është i obliguar të tregojë informacione apo të konsultohet kur natyre e atyre informacioneve apo konsultimeve është e tillë që sipas kriterëve objektive në mënyrë serioze do të cenonte apo do të vendoste në pikëpyetje funksionimin e punëdhënësit.

### **Ndalesë konkurruese (ndalesë ligjore për veprim konkurrues) dhe klauzolë konkurruese (ndalesë kontraktuese për veprim konkurrues)**

#### *Ndalesë konkurruese*

Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës, punëtori nuk guxon pa autorizimin e punëdhënësit për interesin e tij apo të dikujt tjetër të bëjë apo të lidhë gjëra që i takojnë punëdhënësit apo të cilat do të nënkuptonin se janë konkurrencë për punëdhënësin. Punëdhënësi mund të kërkojë

dëmshpërblim për dëmin që është paraqitur me veprimin e punëtorit në të kundërtën e rregullave sipas marrëveshjes, në afat prej tre muajve nga dita kur ka mësuar për kryerjen e punës apo lidhjen e biznesit, gjegjësisht në afat prej dy viteve nga përfundimi i punës apo lidhjes së biznesit.

#### *Konkurrencë konkurruese*

Nëse punëtori gjatë punës së tij apo në lidhje me punën fiton njohuri teknike, prodhuese apo të biznesit, në marrëveshjen për punësim punëtori dhe punëdhënësi mund të merren vesh për ndalesën e kryerjes së veprimit konkurrues pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës (klauzolë konkurruese). Klauzola konkurruese mund të kontraktohet në periudhë më të gjatë se dy viteve pas përfundimit të marrëveshjes për punësim, edhe atë vetëm në raste kur punëtorit i ndërpritet marrëveshja për punësim me dëshirën apo fajin e tij. Klauzola konkurruese nuk guxon të përjashtoj mundësinë për punësimin e punëtorit. Nëse klauzola konkurruese nuk bëhet në formë të shkruar, konsiderohet si e pavlefshme.

### **Obligimet e punëdhënësit**

Punëdhënësi është i obliguar që punëtorit t'i sigurojë punë për të cilën palët janë marrë vesh në marrëveshjen për punësim. Nëse marrëveshja është ndryshe, punëdhënësi punëtorit është i obliguar t'ia sigurojë të gjitha mjetet e nevojshme dhe materialin e punës që të mundet i njëjti pa pengesë t'i përmbushë obligimet e tij dhe t'i mundësojë qasje të lirë deri në hapësirat e punës. Punëdhënësi është i obliguar që punëtorit t'i përcaktojë pagesë përkatëse për kryerjen e punës.

Punëdhënësi patjetër duhet të sigurojë kushte për sigurinë e jetës dhe shëndetit të punëtorëve në përputhje me dispozitat për shëndet dhe siguri gjatë punës dhe t'i ndërmarrë masat e nevojshme me të cilat garantohet se secilit punëtor i është dhënë trajnimi i mjaftueshëm përkatës me karakteristikat e veçanta të punës, duke mbajtur llogari për përgatitjen dhe përvojën e tij profesionale. Punëdhënësi duhet të vlerësojë rrezikun në kuptim të kontrollit sistematik për lëndime apo dëmtim të shëndetit tek punëtorët apo kushtet e sigurta të punës.

Pas njoftimit se ndonjëra nga të punësuarat është shtatzëne, gjatë fazave të ndryshme të

shtatzënisë punëdhënësi është i obliguar të miratojë vlerësim të rreziqeve që mund të ndikojnë ndaj gruas shtatzëne apo fëmijës/frytit të saj të palindur. Në mënyrë shtesë, vlerësimi i rrezikut zbatohet edhe gjatë ndryshimit të kushteve të punës, pajisjes apo makinave. Pas konsultimeve përkatëse dhe pajtimit të gruas, dhe varësisht nga natyra e intensitetit të kohëzgjatjes së rrezikut, punëdhënësi duhet të miratojë masa për përmirësimin e shëndetit dhe sigurisë gjatë punës për punëtoren shtatzëne, punëtore që tanimë ka lindur apo gjidhënëse etj.

Nëse gjatë vlerësimit të rrezikut nuk detektohet ndonjë rrezik, punëdhënësi duhet t'i informojë të gjithë të punësuarit për rreziqet potenciale. Gjithashtu, punëdhënësi duhet të shpjegojë çfarë do të bëjë në përgjithësi që të sigurohet se punëtoret tjera shtatzëna nuk do t'i ekspozohen rreziqeve që mund të shkaktojnë dëmtim në shëndetin dhe sigurinë e tyre.

### **Obligimet për sigurim të obligueshëm social**

Në sigurim të obligueshëm social bëjnë pjesë kontributet për:

- 1) në sigurimin pensional dhe invalidor në bazë të pagesës së rrjedhshme;
- 2) sigurim të obligueshëm kapital të financuar pensional
- 3) stazhi i sigurimit që konsiderohet me kohëzgjatje të rritur
- 4) sigurim shëndetësor dhe
- 5) sigurim në rast të papunësisë.

I obliguar për pagesën e kontributit për sigurim të obligueshëm pensional dhe invalidor është :1) punëtor në marrëdhënie pune tek ndonjë person fizik, person i vet- punësuar, institucion, person tjetër fizik që kryen punë në shërbim publik, organ shtetëror apo organ i njësisive të vetëqeverisjes lokale dhe qytetin e Shkupit; 2) shtetas i RM-së që në territorin e RM-së është punësuar në ndonjë organ të huaj apo ndërkombëtarë, organizata apo institucione, tek diplomat apo përfaqësi të huaja konsulare, në shërbim personal të diplomatëve të huaj apo përfaqësi konsulare apo është në shërbim personal të të huajve, nëse me marrëveshje ndërkombëtare i ratifikuar nga RM nuk thuhet e

kundërta; 3) shtetas i RM-së që është në marrëdhënie pune jashtë vendit, kryen veprimtari jashtë vendit apo është dërguar për punë jashtë vendit, nuk gjatë kësaj kohe nuk ka fituar sigurim të obligueshëm tek bartësi i huaj i sigurimit, nëse me marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar nga RM nuk thuhet e kundërta; :4) shtetas i RM-së i punësuar jashtë vendit në shtet ku ka sigurim të obligueshëm, por nuk mund t'i realizoj të drejtat e sigurimit pensional- invalidor apo nuk mund t'i shfrytëzoj jashtë atij shtetit; 5) person i vet-punësuar; 6) bartës i ekonomisë familjare bujqësore të kategorisë së parë, dytë dhe tretë në përputhje me Ligjin për zhvillim bujqësor dhe rural; 7) person zyrtar fetar; 8) person i papunësuar përkohësisht derisa pranon kompensim në të holla nga sigurimi në rast të papunësisë, në përputhje me ligjin; 9) invaliditet gjatë kohës së shfrytëzimit të rehabilitimit profesional në përputhje me ligjin; 10) artist i pavarur që këtë status e ka fituar sipas kriterëve; 11) sportist që këtë status e ka fituar sipas kriterëve, në procedurë përkatëse dhe me akt përkatës nga Agjencia për të rinj dhe sport; 12) i huaj që në territorin e RM-së është në marrëdhënie pune apo në shërbim të personave të huaj fizik apo juridik, organizata ndërkombëtare apo përfaqësi të huaja diplomatike e konsulare, nëse me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga RM nuk thuhet ndryshe.

Në lidhje me angazhimin e personave me marrëveshje në vepër, marrëveshje autoriale apo marrëveshje tjetër, që nuk përfshihen me Ligjin për kontribute nga sigurimi i obligueshëm social, disa ndryshimet e njëpasnjëshme të cilat i pësuan ligjet gjatë vitit 2015 krijuan konfuzion dhe hamendje të mëdha te të punësuarit dhe punëdhënësit lidhur me pagesën e kontributeve dhe tatimeve për të angazhuarit me honorar. Kjo sidomos ishte e dukshme në sferën e internet mediave, ku vërehet numër i madh i të angazhuarve me honorar. Ndryshimet shkaktuan revolt të madh tek opinioni dhe protesta masive.

Pas anulimit të këtyre ndryshimeve në gusht të vitit 2015, gjatë kyçjes së marrëveshjeve autoriale dhe kontratave mbi vepër, mbetet obligim i personit juridik të paguajë tatimin për të ardhura personale.

## **Përvojë me zbatimimin e legjislacionit për marrëdhëniet e punës te mediat e internetit**

Marrëdhëniet e punës te mediat e internetit në pjesën më të madhe janë problematike. Edhe pse tregu dhe numri i konsumatorëve rritet, kjo nuk reflektohet në mënyrë përkatëse edhe në vet mediat e internetit, paraqitja e redaksive më të mëdha, më të mira dhe më profesioniste, rroga më të larta dhe kushte më të mira. Përkundrazi, pikërisht në pjesën më me shpresë dhe perspektivë të industrisë mediatike në Maqedoni ka më pak të holla, edhe në vet kompanitë edhe në pjesën e reklamave.

Sipas sindikatave dhe shoqatave profesionale, të drejtat e punëtorëve në mediat e internetit janë nivelin më të ulët të industrisë mediatike. Në lidhje me organizimin sindikal të mediat të internetit, edhe këtu gjërat shkojnë shumë rëndë, më vështirë krahasohet me mediat kryesore, thonë sindikalistët. Te mediat e internetit ndikoj edhe veçoria e profesionit sepse këto nuk janë redaksi klasike dhe ka numër të madh të redaksive ku njerëzit shpesh nuk shkojnë fizikisht në punë, të shpeshtën janë me marrëveshje autoriale, dhe këta quhen punëtorë të jashtëm. Nuk kanë kurrfarë sigurie dhe nuk mund të luftojnë për të drejtat në vendin e tyre të punës sepse shumica e tyre realisht nuk kanë vend pune, por kanë angazhime të përkohshme, që siç njoftojnë nga Sindikata, mund të ndërpresin edhe me SMS porosi.

Edhe pse Ligji për Marrëdhënie Pune mundëson mekanizma që ata të kenë marrëveshje për punë nga shtëpia, për punë prej 2 orë, 4 orë, për punë për më shumë punëdhënës, asnjëra prej këtyre mundësive nuk shfrytëzohet nga punëdhënësit.

Një hulumtim i SPGP për punën nga jashtë tregon se nëse puna nga jashtë është 1/3 në mediat në përgjithësi, në portalet e internetit është 80%. Sindikata thotë se ka pasur shumë ankesa nga gazetarët që punojnë në portale të internetit, por nuk kanë shkuar të bisedojnë me pronarët sepse të njëjtit kanë refuzuar biseda.

*Rasti 1. Honorarist në portal ndërsa punon njëjtë apo më shumë se të punësuarit tjerë*

Një gazetarë në online-portal, që insiston të mbetet anonime, për hulumtimin e SPGP thotë se

ajo ka obligime të njëjta sikur gazetarët e punësuar, madje ka orar më të gjatë se disa të punësuar tjerë. Punon çdo ditë, ndonjëherë edhe të dielën, ka dy javë pushim, që punëdhënësi ia jep sipas vullnetit të tij të mirë. Tërë jetën është honorariste, nuk ka asnjë ditë stazh, nuk ka sigurim shëndetësor ndërsa në mjek shkon privatisht. Marrëveshja nuk është e njëjtë me atë që ndodh në realitet sepse koha që shkruan se e kalon në punë në fakt është një e treta e asaj që në të vërtetë e kalon në punë. Punësimi i saj është i pasigurt dhe është e vetëdijshme se nesër mund ta largojnë nga puna pa kurrfarë problemi<sup>33</sup>.

### **2.3.5. ZBATIMI I LIGJIT MBI MATERIALIN ARKIVOR**

Materiali arkivor është tërësi burimore dhe i riprodhuar (i shkruar, i vizatuar, i shtypur, i fotografuar, i filmuar, audiovizual, mekanografik, elektronik, digjital, optik si dhe ne forma tjera të shpalljes), material i dokumentuar me vlerë të përhershme me rëndësi për Republikën, shkencën, kulturën, poseduesit, si dhe për përdorime tjera;

Dokument/regjistër është informacion i regjistruar, i krijuar ose i zbatuar gjatë inicimit, ekzekutimit ose kryerjes së aktivitetit të organit të caktuar, personit juridik apo fizik dhe i përfshin në masë të mjaftueshme përmbajtjen kontekstin dhe strukturën, ashtu që pavarësisht nga forma apo bartësit të regjistrimit, jep provë për aktivitetin në fjalë.

Karakteristikat themelore të dokumentit/regjistrimit është origjinaliteti, vërtetësia, tërësia dhe:

- a) autentik është ai dokument është ai dokument që mund të vërtetohet ajo që është e shkruar në atë dokument, të cilin e ka formuar ose dërguar ai për të cilin vërtetohet se e ka përpiluar ose dërguar dhe se është përpiluar apo dorëzuar në kohën për të cilin vërtetohet se është përpiluar dhe dorëzuar;
- b) i besueshëm është ai dokument në përbërjen e të cilit mund të besohet se në mënyrë të tërësishme dhe të saktë i shprehë aktivitetet ose faktet të cilat e përbëjnë atë përmbajtje;

33 SPGP – Puna me nofka në industrinë mediatike, fq.14 <http://snm.org.mk/wp-content/uploads/2014/11/Prekarna-rabota-vo-medi-umskata-industrija-fin.pdf>

v) i tërësishëm është ai dokument që është plotësisht i pandryshueshëm

g) i përdorshëm është ai dokument i cili mund të identifikohet, të lokalizohet, të kërkohet, të prezantohet dhe të interpretohet.

Puna në byro paraqet pranimin, shqyrtimin dhe renditjen e dokumentit/shkresës, evidentimi i dokumentit/shkresës, dorëzimi i dokument/shkresës, në punë, përpunimi administrativo-teknik i dokumentit/shkresës, dorëzimi i dokumentit/shkresës, çregjistrimi dhe klasifikimi i dokumentit/shkresës dhe prolongimi i vendimit/shkresës në shkrimore.

Puna arkivore paraqet përzgjedhjen e materialit arkivor nga materiali dokumentar, rregullimi i materialit dokumentar dhe arkivor, evidentimi, (regjistrimi dhe përshkrimi) i materialit arkivor, kategorizimi i materialit arkivor, përzgjedhja e materialit dokumentar të cilit i ka skaduar afati i ruajtjes, zhdukja e materialit dokumentar të propozuar, vendosja, ruajtja, mbrojtja, sigurimi dhe shfrytëzimi i materialit dokumentar dhe arkivor në hapësira adekuate, pajisje standarde, mjete tekniko-teknologjike dhe dorëzimi i materialit arkivor në ruajtje të përhershme në arkivin shtetërorë.

Arkiva elektronike përfshinë ruajtjen në dokumente elektronike në formën burimore në të cilën janë të përpiluar, dorëzuar, pranuar dhe të arkivuar, forma në të cilën përmbajtja burimore nuk ndryshon. Dokumente elektronike ruhen në formë burimore në sistemin informatik të mediave, të cilët mundësojnë jetëgjatësi të shkrimit elektronik gjatë afatit të paraparë të jetëgjatësisë dhe është pjesë e arkivit elektronike. Të dhënat të evidentuara në bazën të digjitale të të dhënave dhe fotografitë digjitale të dokumenteve të pranuar nga digjitalizimi i dokumenteve konvencionale, ruhen në formë e cila i siguron nga qasja e pa autorizuar, fshirja, ndryshimin apo humbjen e të dhënave, në përputhshmëri me ligjin dhe aktet tjera për administrimin dhe mbrojtjen e sistemit informativ (krijimi i përditshëm i kopjeve rezerve të kompakt disqeve, DVD, shiritit magnetik, disk i fort mobil ose në server nga ndonjë provajder, i cili jep shërbime për ruajtjen në bazën e të dhënave në përputhshmëri me normat ligjore).

Poseduesit privat të materialit arkivor dhe dokumentar janë të detyruar të mbajnë evidencë personale dhe themelore për materialin arkivor dhe dokumentar, të aprovojnë plan për shenjat arkivore me listë të materialit të arkivuar dhe dokumentarë, të bëjnë seleksionim të materialit arkivor dhe dokumentar dhe ti ruajnë në afat të pacaktuar në përputhshmëri me këtë ligj.

Në përjashtim, poseduesit privat të materialit arkivor të cilët kanë deri 49 të punësuar janë të obliguar të aprovojnë plan për shenjat arkivore me listë të materialit arkivor dhe dokumentar po që se posedojnë material arkivor dhe ta ruajnë pa afat të pacaktuar materialin arkivor.

## 2.4. VETËRREGULLIMI

Vetërregullimi i mediave është angazhim i profesionistëve të mediave për të krijuar vullnetarisht dhe të mbrojnë standardet themelore profesionale dhe etike në gazetari përmes etikës dhe organeve për zbatimin e standardeve.

Modelet e mekanizmave të vetërregullimit janë të ndryshme dhe ndryshojnë nga shteti në shtet varësisht nga veçantitë lokale dhe historike. Format më të njohura dhe më të përhapura janë autoritetet kolegjiale (këshillat mediatike, komisionet e ankesave, gjykatat e nderit). Pak më shumë se gjysma e këshillave kombëtare në Evropë rregullojnë sjelljen e të gjitha mediave, ndërsa të tjerët vetëm mediat e shkruara.

### 2.4.1. KËSHILLI I NDERIT I SHGM

Këshilli i Nderit i SHGM. I cili mund të vendos vetëm sanksione morale (deklarata publike) dhe kodin e tij. Të dy mekanizmat e krijuar dhe miratuar në vitin 2001 me mbështetjen e gjerë të komunitetit të medias, deri kohët e fundit ishin të vetmet mekanizma të vetërregullimit për mediat në Maqedoni. Detyra e tyre kryesore është për të mbrojtur dhe promovuar parimet etike, kriteret dhe standardet të gazetarisë profesionale dhe të përgjithshme, siç përshkruhet në Kodin e Etikës së Gazetarëve të Maqedonisë. Të gjitha pjesët e Kodit janë të aplikueshme për mediat e internetit dhe gazetarëve.

Kodi ka anëtarë që kanë të bëjnë në mënyrë specifike për gjuhën e urrejtjes dhe diskriminim-



it, të cilat janë ndër shkeljet më të shpeshta nga ana e mediave. Përkatësisht në nenin 10 të kodit të gazetarëve thuhet: “Gazetarët nuk mund me vetëdije të krijojnë as të përpunojnë informacion e që kërkojnë të drejtat ose lirit e njeriut, nuk do të përdorin gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisin dhunë ose diskriminim mbi çfarëdo lloj baze” (nacionale, fetare, gjinisë, klasës shoqërore, gjuhës, orientimit seksual, orientimit politik...). Gjithash-tu në nenin 11 thuhet se: “Një gazetarë do ti respektoj standardet e pranuar shoqërore të mirësjeljes dhe do të respektoj diverzitetin etnik, kulturor dhe fetar në Republikën e Maqedonisë”.

Me kalimin e viteve puna e Këshillit të Nderit u përmirësua dhe suksesi i tij i kufizuar deri më tani lidhur me tri arsye: Ndarjet politike në mesin e gazetarëve, burimet shumë të kufizuara për të punuar në rastet e shkeljes së etikës dhe mungesa e partneritetit me lojtarë të tjerë të mediave: Menaxhimi, përfaqësues të shoqërisë civile, ekspert në fushën e etikës së mediave.

#### 2.4.2. KËSHILLI PËR ETIKË NË MEDIA-KEMM

Përvojat e reja të vetë-rregullimit të medias i rekomandojnë modelet integruese “trepalëshe” të organeve vetë-rregulluese, të përbëra nga përfaqësues të pjesëmarrësve më të rëndësishëm në media: pronarët e mediave, gazetarët dhe konsumatorët - publiku. Me këtë strukturë theksohet se gazetarët dhe botuesit (pronarët) kanë një përgjegjësi edhe ndaj kolegëve të tyre porse edhe ndaj përdoruesve. Duke qenë se vetë-rregullimi duhet ti shërbejë interesit publik, si model më i mirë konsiderohet modeli i kontrollit dhe ndikimit të ndërsjellë të partnerëve. Ky model e tejkalon jotransparencën potenciale, apo edhe izolimin dhe vetë-mjaftueshmërinë, dhe në mënyrë të konsiderueshme rrit kredibilitetin e përgjithshëm të këtyre organeve. Prandaj, një model i tillë është përdorur për të formuar Këshillin e për etikë në media në Maqedoni, organizatë formimit të të cilës i paraprinë aktivitetet disavjeçare përgatitore të organizuara nga MIM dhe SHGM në periudhën 2010 - 2014. Këshilli për etikë në media në Maqedoni (KEMM) u formua në fillim të vitit 2014. Ai është një organizatë joqeveritare, jopolitike dhe jofitimprurëse, i bazuar mbi parimin e vullnetit të lirë, e që i bashkon anëtarët e saj për realizimin e objektivave

dhe aktivitetet të përcaktuara me statut. Këshilli e bazon punën e tij në parimet e transparencës dhe publikes dhe lirshëm i promovon pikëpamjet dhe mendimet e tij, ndërmerr iniciativa dhe merr pjesë në ndërtimin dhe përmirësimin, mbrojtjen dhe avancimin e standardeve profesionale dhe etikës në media në vend. Komisioni për ankesa pranë KEMM, duke u bazuar në Librin e punës së tij, i shqyrton parashtresat e qytetarëve dhe nëse konstaton se është shkelur Kodi i gazetarëve, shqipton sanksione morale. Në rast të shkeljes së Kodit, KEMM vendos për ankesat e qytetarëve dhe shqipton dënime morale. Mediat të cilët janë anëtarë të KEMM janë të detyruar t'i respektojnë dhe publikojnë vendimet e këshillit. Rasti 1: Organizatë joqeveritare kundër medias së internetit për përmbajtje lidhur me orientimin seksual Një organizatë joqeveritare për mbrojtje të të drejtave të njeriut ka ngritur parashtresë para Komisionit për ankesa të KEMM, për një përmbajtje të botuar në një faqe të internetit maqedonase e cila ka botuar përmbajtje të kontestueshme për pjesëtarët e pakicave seksuale. Në vendimin e tij Këshilli konstaton thyerje të neneve 9, 10, 11, 13, dhe 15 të Kodit të gazetarëve dhe konstaton se parashtresa e organizatës joqeveritare është e bazuar. Rasti 2: Redaktorja televizive kundër mediave të internetit për përmbajtje fyese. Një redaktore televizive në një televizion privat kombëtar ka ngritur parashtresë para Komisionit për ankesa të KEMM lidhur me botimin e dy faqeve të internetit maqedonase të cilat kanë botuar përmbajtje në të cilat për redaktoren përdorin fjalë dhe cilësime fyese. Në vendimin e tij, Këshilli konstaton thyerje të neneve 10, 15 dhe 16 të Kodit të gazetarëve dhe konstaton se parashtresa e redaktores televizive është e bazuar.

#### *Rasti 3: Deputet kundër portalit të internetit për përmbajtje fyese*

Deputet i Kuvendit të RM ka ngritur ankim në Komisionin për ankesa në KEMM, në lidhje me përmbajtjen e publikuar në një faqe të internetit në gjuhën shqipe, e cila ka publikuar përmbajtje në të cilën për deputetin janë përdorur fjalë fyese dhe kualifikime. Deputeti ka kërkuar tërheqje të tekstit dhe ti kërkohej falje publike nga portali. Këshilli ka filluar procesin e ndërmjetësimit. Ka kontaktuar me përgjegjësit e portalit të internetit, të cilët kanë vlerësuar që teksti i tyre ka qenë sat-

irë, dhe nuk i ka thyer standardet etike dhe profesionale, por janë pajtuar me një pjesë të pretendimeve të ankesës, dhe me atë që teksti të tërhiqet, por nuk kanë vlerësuar që për tekstin në fjalë është e nevojshme të kërkojnë falje publike.

KEMM më tej kanë kontaktuar me deputetin për të shpallur qëndrimin e redaksisë dhe ta pyesin për qëllimet e tij të mëtejshme në lidhje me procedurën, por deputeti më tej nuk ka kontaktuar për këtë ankesë me KEMM.

Vendimet dhe mendimet në Komisionin për parashtresa në KEMM botohen publikisht në ueb-faqen e Këshillit etik. Sipas shtrirjes së punës së deritanishme, mund të thuhet që ky trup fillon të jetësohet dhe të realizojë funksionin e tij, dhe që aktorë të rëndësishëm shoqëror (funksionar shtetëror, politikan, media dhe gazetarë, organizata qytetare) po fillojnë ta përdorin këtë mekanizëm. Pjesëmarrja është, si tek të gjithë trupat tjerë në vitet e para të funksionimit, më i ulët në ankesat individuale të qytetarëve.

Problemet kryesore me të cilat ballafaqohet funksionimi i Këshillit të Etikës është mospranimi i trupit nga ana e një pjesë të shoqërisë mediatike dhe mediave, mospublikimi i vendimeve nga shkelësit, me çka humbet efekti i sanksionit moral, si dhe informimi jo i mjaftueshëm i opinionit dhe qytetarëve për ekzistimin dhe mënyrën e funksionimit të këtij mekanizmi. Rrezik potencial në të ardhmen është funksionimi i KEMM, përdorimi i së cilës nga ana e qytetarëve në të ardhmen mund të rritet, por kjo duhet të shoqërohet me mbështetjen e duhur financiare, teknike dhe burimet njerëzore që do të përgjigjen nevojave të qytetarëve dhe mediave.

#### **2.4.3. FORMAT TJERA TË BASHKIMIT PROFESIONAL TË MEDIAVE TË INTERNETIT**

Në gusht të vitit 2013, siç ishte publikuar në disa faqe të internetit, dhjetëra portale të internetit maqedonase u bashkuan në asociacionin e portaleve të internetit në Maqedoni, për të përmirësuar statusin e gazetarëve të internetit, mbrojtjen e të drejtës të autorit dhe të drejtave sociale dhe përmasimin e kushteve për biznes në online-domenin. Shoqata, siç informuan vetë portalet informative të internetit, është themeluar para

aprovimit të ligjit të ri mbi mediat me qëllim që të inkorporohet në dispozitat për të garantuar të drejtat dhe detyrimet në këtë sektor të ri mediatik<sup>34</sup>.

Mediat e internetit nuk u bënë pjesë e ligjit, e edhe kjo shoqatë, përveç pjesëmarrjes në debatin publik për ligjet mediatike, deri tani nuk është organizuar dhe realizuar asnjë aktivitet të dukshëm publik.

Iniciativë e ngjashme për bashkimin e portaleve të internetit kishte edhe në sektorin civil nëpërmjet projektit të Fondacionit Metamorfozis, por edhe atje në aktivitetet fillestare nuk ka ndonjë avancim në këtë drejtim.

---

34 <http://www.maxim.mk/formirano-prvoto-zdruzhenie-namakedonskite-internet-portali>

### 3. PERCEPTIMET E AUDIENCËS SË INTERNETIT PËR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT DHE VETËRREGULIMIT NË INTERNE (ANKETA)

Si pjesë e këtij studimi, në lidhje me informimin dhe perceptimet e audiences (publikut) për kornizën ligjore dhe mekanizmat për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve dhe subjekteve tjera në domenin e internetit, ne kuadër të studimit u realizua on-line-anketa përmes komunikimit të drejtpërdrejtë elektronik me pronarët, redaktorët dhe gazetarët në mediat e internetit, aktivistë të shoqërisë civile dhe shpallja e rrjeteve sociale dedikuar për publikun e gjerë.

Anketës iu përgjigjen 135 të anketuar. Edhe pse shembulli nuk është reprezentativ nga aspekti demografik për popullsisë së përgjithshme, të anketuar për studimin ishin një pjesë aktive dhe e kualifikuar e audiencës së synuar në internet, e cila çdo ditë dhe në mënyrë aktive krijon përmbajtje dhe jep mendimin e tij mbi përmbajtjen e vendosur në internet, kështu që ky studim me një audiencë të kualifikuar mund të konsiderohet i vlefshëm në zbulimin e trendeve dhe perceptimet e kualifikuara dhe profesionale të publikut në lidhje me pyetjet e parashtruara, për shkak se nuk bëhet fjalë për persona laik, por për njerëzit që çdo ditë, shpeshherë dhe profesionalisht përdorin komunikimin në internet.

Pyetëtori fokusohet në përvojat dhe perceptimet e të anketuarve në raport me domenin legjislativ janë lëndë e analizave (korniza juridike, mekanizma e mbrojtjes të së drejtave, gjyqësori dhe praktika, dispozitat ndëshkuese, vetërregullimi).

Konstatimet e kësaj ankete tregojnë disa tendenca në raport me konstatimet të cilat i detektoi vetë studimi i hulumtimit të internet/sferës dhe qasja e të dhënave. E dukshme është rritja e gjuhës së urrejtjes dhe diskursit fyes, por edhe identifikimi i tij.

Në pyetjen a kanë qenë pre e gjuhës së urrejtjes në internet, me “po” janë përgjigjur 38 ose 28,1 % nga të anketuarit, a me „jo“ 97, ose 71,9% nga të anketuarit. Në raport me atë se a kanë qenë dëshmitar të gjuhës së urrejtjes i realizuar nga

publikimet në internet, me po janë përgjigjur 105 ose 77,8% nga të anketuarit, a me „jo“ 30, ose 22,2% nga të anketuarit. Të pyetur a kanë qenë pre e fyerjes dhe shpifjeve në internet, pozitivisht janë përgjigju 38, ose 28,6%, a negativisht 95, ose 71,4% të anketuarve. Që kanë identifikuar fyerje apo shpifje në mediat e internetit pozitivisht janë përgjigjur 60,9%, të anketuarve. Këto statistika qartë tregojnë në tendencën e rritjes dhe dëshmojnë në prezencën masive të shprehjeve diskualifikuese. Të anketuarit kanë perceptuar edhe probleme në respektimin e të drejtës së autorit. Në 28,8%, sipas anketës, u është cenuar e drejta e autorit, a 45,9% e të anketuarve kanë qenë dëshmitar të cenimit të drejtës së autorit në internet. 26,2% e të anketuarve kanë qenë dëshmitarë të shkeljes të Ligjit për mbrojtje e të dhënave personale me publikim në internet.

Por i dukshëm është edhe mos informimi i mos besimi i të anketuarve në institucionet dhe mekanizmat që janë vendosur, ndër të tjera, dhe për rregullimin e komunikimit në internet dhe përmbajtjeve. Prej të gjithë të anketuarve vetëm një person ka padit, dy kanë qenë të paditur për publikim në internet. Në pyetjen a e dinë ku të denoncojnë shkeljet ligjore lidhur me paraqitjet në internet ose në online-komunikim, me “po” janë përgjigjur 25%, a 75% ose tre të katërtat e të anketuarve nuk kanë dijeni cilit organ ti referohen për cenimin e të drejtave të tyre në internet.

Të anketuarit i pyetëm cilët ligje i dedikohen sferës së internetit, duke dhënë mundësi të zgjedhin më shumë ligje nga lista e përpiluar më parë ose përshkruajnë ligje tjera. Sipas përgjigjeve, qartë vërehet se informatat më të mira kanë për Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, sepse 116 nga të anketuarit, gjegjësisht 94,3%, mendojnë se ky ligj vlen për internetin. 71,5% nga të anketuarit mendojnë se për komunikimin në internet vlen Ligji për Komunikim Elektronik. Vijon Ligji për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje (63,4% nga të anketuarit), Ligji për të drejtat e autorit i të drejtat e ngjashme (55,3%), Ligji për qasje të lire ndaj informatave me karakter publik (48,8%). Kodi penal ka aplikacion edhe në komunikimin e internetit mendojnë vetëm 40,7% nga të anketuarit.

Madje 51,2% e të anketuarve mendojnë për internetin vlen edhe ligji mbi mediat, ndërsa 36,6%

mendojnë se për mediat e internetit vlen edhe ligji për audio dhe shërbime audivizuale mediatike, edhe pse sipas definicioneve të tanishme ligjore kjo nuk është e saktë. Në anën tjetër, indikative është edhe ajo se vetëm 15% e të anketuarve mendojnë se Ligji për marrëdhëniet e punës vlen edhe në domenin e internetit. E njëjta vlen edhe për ligjet që kanë të bëjnë me punët afariste si dhe ligji për të drejtën e detyrimeve (6,5% e të anketuarve), ose ligji për shoqatat tregtare –vetëm 5,7% e të anketuarve mendojnë se ky ligj vlen edhe për subjektet e internetit.

Në raport me shfrytëzimin e mekanizmave për vetërregullim, të të anketuarit gjithashtu ekziston mos njohja, por edhe shfrytëzim modest i këtyre mekanizmave. Në pyetjen a keni ngritur parashtrësia apo keni qenë i subjekt i parashtrësive nga trupat vetërregullues të mediave, pozitivisht janë përgjigjur vetëm 3,8% e të anketuarve.

## 4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Maqedonia posedon legjislacion të mirë dhe të mjaftueshëm, i cili është i zbatueshëm në domenin e internetit dhe nuk ka nevojë për rregullim plotësues të komunikimit në internet. Edhe pse nuk është e përfshirë në Ligjin mbi Mediat, AVMU, për komunikimin në internet ekziston kornizë e mjaftueshme ligjore, e përfshirë në ligjet të cilët janë çështje e analizës së këtij studimi, por edhe me norma tjera ligjore, të cilat vlejné në përgjithësi për të gjithë qytetarët e Maqedonisë. Sindromi i “stërregullimit” duhet të tejkalohet, nëpërmjet analizave kualitative dhe profesionale, të bazuara në argumente dhe profesionalizëm, a jo preferenca politike dhe me debate publike kualitative nëpërmjet të cilave do të vijë deri te zgjidhje apo vendime të cilat do lehtësojnë, a jo ti stërngarkojné raportet juridike mes qytetarëve në komunikimin e internetit. Zgjedhjet ligjore nuk duhet të jenë të përsheptuara dhe të ndryshojné shpesh, përkundrazi duhet të përmbajnë zgjidhje afatgjate.

Kultura e mos ndëshkimit duhet të pushoj. Legjislacioni duhet të zbatohet në mënyrë joselektive, të drejtë dhe proporcionale, ndaj të gjithë aktorëve në komunikimin publik në internet, Kjo posaçërisht vlen për zbatimin e Kodit penal dhe dispozitat e gjuhës së urrejtjes, Ligji për shpifje dhe fyerje, Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga diskriminimi, por edhe në pjesën e Ligjit për marrëdhënie të punës dhe Ligji për të drejtat e autorit. Shembujt e pakt të zbatimit të ligjeve në këtë drejtim, gjithësesi, vërtetojnë se parimi ekziston se mediat dhe komunikimi publik, pa marrë parasysh a është në internet apo jo, nuk guxon të shfrytëzohet në cenimin e të drejtave njerëzore dhe dinjitetin njerëzor.

Për këtë nevojitet veprim shumëdimensional dhe veprim intersektoral të gjithë aktorëve të prekur-institucionet, mediat, organizatat civile dhe të gjithë subjektet e interesuara. Nevojiten më shumë resurse financiare, më shumë projekte dhe aktivitete për zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve në shoqëri dhe media të cilët do të përgjigjen sfidave të kohës të digjitalizimit, e cila do të mundësoj qytetarëve informacione, të dhëna dhe fakte të cilët do tu ndihmojnë të sjellin zgjed-

hje informative dhe përfundime, por edhe të realizojné të drejtat e tyre.

Përmirësime të dukshme janë të dëshirueshme dhe të mundshme dhe në zbatimin e Ligjit për qasjen e informatave të karakterit publik, posaçërisht në pjesën e zbatimit të ligjit nga palët të cilët i posedojné informatat, por edhe në pjesën e edukimit të mediave dhe opinionit për mënyrat dhe procedurat se si të vinë deri te informatat e kërkuara, si dhe si institucionet të jenë më transparente dhe të përgjegjshme në punën e tyre.

Shkrim-këndimi mediatik duhet të jetë i inkorporuar edhe në mediat, dhe në sistemin arsimor. Mediat dhe organizatat mediatike duhet të marrin pjesët e përgjegjësisë dhe të forcojnë kapacitetet dhe dimensionet edukative të mediave, të cilat deri tani thuajse janë harruar, a institucionet arsimore të mundësojnë përkrahje financiare dhe përkrahje tjera rreth realizimit të projekteve dhe aktiviteteve nga fusha e mediave dhe vetëdijes digjitale dhe të përfshihen si pjesë obligative e programeve mësimore, a jo vetëm me aktivitete ekstrakurikulare.

Të gjithë partneret social në sistemin mediatik për të cilët do vlerësohet se mund të funksionojné dhe të kontribuojné në ngritjen profesionale dhe standardet etike dhe autoritetin e gazetarisë dhe mediave të internetit në Maqedoni, duhet të përipiqen në stimulimi për vetërregullim. Institucionet duhet të inkurajojnë vetërregullimin nëpërmjet bashkëpunimit me trupat vetërregullatorë dhe mediat të cilat i përmbahen standardeve etike dhe profesionale. Mediat duhet dukshëm t'i përmirësojnë përmbajtjet e tyre nëpërmjet investimeve dhe përmirësimit të kushteve për kuadrin e tyre nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm të punonjësve mediatik.